

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7814 E premte 8 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Tetë muaj pas lançimit të tezës mbi korrëgjimin e kufirit në "Bursën" politike ndërkombëtare, pa dashur të përsëritim faktet dhe argumentet e shumta mbi ...
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE
"Patate e nxehtë" apo "hallvë e ftohtë"?


Opinion *i* **Ditës**
Duhet pranuar se propaganda mbetet pika e fortë e Edi Ramës, e aty nuk ka rivalë. Por nëse brenda vendit, me kontrollin financiar që ushtron ndaj mediave ...
Vijon në faqen 21

Nga BARDH SPAHIA
Një kryeministër mjeran e i izoluar




Dialogu/ Vendimi i Konferencës së Kryetarëve

PS anulon të gjitha nismat e PD-LSI në Kuvend. Basha: Nuk ka dialog me Ramën

Prapaskenat, Kuvendi anuloi fjalimin në seancë të presidentit të Sllovenisë nga frika e protestës

Nga VALENTINA MADANI

Opozita mbetet e palëkundur në qëndrimin e saj se nuk ka dialog me Edi Ramën ndërsa apelon për shembjen e gjithë sistemit me qëllim shmangien e përfshirjes së kriminelëve në politikë. Nga takimi që pati dje me Drejtorin e ...

Në faqet 2-4

LIGJI I RI/ DERI ME 20 PRILL PAGUHET VETEM TARIFA, FALEN KAMATEVONESAT

HIPOTEKA, "AMNISTI" PER REGJISTRIMIN E PRONES

Krijohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës, bien përkohësisht gjohet që shkonin deri në 300 mijë lekë të rinj. Procedura, si aplikohet për hipotekën



(Në foto) Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tirane

Në faqen 5

VENDIMI

Drejtoria e Transporteve rrit pagat për punonjësit në Tiranë e rrethe

Në faqen 5

DREJTORI NE BE

Danielson: Djegia e mandateve minon integrimin e Shqipërisë

Në faqen 3

VIZITA E PRESIDENTIT

Meta në Britaninë e Madhe: Të rritet bashkëpunimi tregtar mes nesh

Në faqen 2

DOKUMENTET

Të përndjekurit, emrat që marrin dëmshpërblimin dhe mungesat në dosje

Në faqet 10-11

KALENDARI



Zbardhen datat e provimit të shtetit për farmacistët dhe infermierët

Në faqen 8

EMRAT/ 6 mijë familjet që iu njihet e drejta për të marrë paratë

Dosjet e '93-2013, pronarët që kompensohen

Agjencia e Trajtimit të Pronës: Si ndahet fondi financiar, kush përfiton

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën e 6 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të



gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtimit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të ...

Në faqet 10-11

KRIZA POLITIKE ZGJIDHJA

Kreu i PD: Të shembet i gjithë sistemi, duhen ndryshime të Kushtetutës së 2008-ës

Formula e zgjidhjes, Basha: Reformë kushtetuese dhe zgjedhore

"Shmang përfshirjen e kriminelëve në politikë"

Valentina Madani

Opozita mbetet e palëkundur në qën drimin e saj se nuk ka dialog me Edi Ramën ndërsa apelon për shembjen e gjithë sistemit me qëllim shmangien e përfshirjes së kriminelëve në politikë. Nga takimi që pati dje me Drejtorin e Përgjithshëm për Politikën Europiane e Fqinjësisë dhe Negocimet e Zgjerimit, Christian Danielsson, Lulzim Basha doli me një formulë zgjidhjeje që sipas tij i jep fund situatës politike në vend. Propozimi që i kishte prezantuar të dërguarit të Brukselit në Tiranë, përfshinte bërjen e një reforme të thellë kushtetuese, duke e cilësuar amendimin e ligjit themeltar të shtetit në kohën kur qeveriste z. Berisha defektos, pasi sipas tij instaloi një sistem që u mundësoi kriminelëve të hynin në parlament. "Na duhet patjetër të shembim këtë sistem, problemet e të cilit ndodhën që në vitin 2008 me ndryshimet kushtetuese. Pra, me qëllimin për të larguar kriminelët nga zonat elektorale, por fuqizimi i rolit të kryetarëve solli më shumë kriminel në parlament, reformë elektorale, dhe vullnet politik, hetim i plotë dosjes 339 dhe 184, çuarja para përgjegjësive penale të politikanëve që kanë vjedhur votat me krimin e organizuar", u shpreh z.Basha. Pas një takimi përreth një orë e gjysmë pjesë e të cilit ishin krerët e partive opozitare, kreu i PD-së deklaroi: "Opozita sot ka pasur një mundësi tjetër jo thjesht dhe vetëm për të shprehur vendosmërinë e saj për të qëndruar kësaj beteje, por kemi shprehur dhe vendosmërinë tonë që jo thjesht të largohet Rama, por të shembet ky sistem. Për të ndërtuar një sistem vlerash europiane në vend", theksoi kreu i PD-së. Z.Basha bëri të qartë se opozita e konsideron



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

NDRYSHIMET

Kreu i PD-së shprehet se nuk duhet vetëm largimi i Ramës, por duhet shembur i gjithë sistemi. Një vizion i ri që, siç tha Basha, do të diskutohet jo vetëm brenda opozitës, por edhe me qytetarët dhe me grupet e interesit. Me shembje të sistemit, Basha sqaroi se i referohet ndryshimit të Kushtetutës, dhe një reforme zgjedhore për të shmangur përfshirjen në politikë të kriminelëve.

Rama: Dhuna nuk e ndryshon qeverinë, çfarë i kërkova Bashës në 2017

Kryeministri Edi Rama akuzoi dje opozitën se nëpërmjet sjelljes së saj dhe protestave të dhunshme po dëmton imazhin e Shqipërisë në botë. Nëpërmjet rubrikës "Përgjigjia ime" në rrjetin social "Facebook", kryeministri ka theksuar se dhuna nuk e ndryshon dëmtimin qeverinë, as e ndryshon atë, por dëmton imazhin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve që jetojnë nëpër botë. "Dhuna nuk e ndryshon dot rrjedhën e përcaktuar nga populli me votë, nuk e ndryshon qeverinë, por e forcon. Dhuna dëmton imazhin e Shqipërisë dhe godet ekonominë. Dobëson familjet që jetojnë me punë", - tha Rama. Nga ana tjetër, ka treguar se gjatë interv-



istave që kishte dhënë në Itali gjatë ditëve të fundit ishte ndërjetë vërtetë keq, kur dëgjonte kreu e opozitës që shante qeverinë në gjuhë të huaj. "Më vjen sinqerisht keq, sepse nuk është e këndshme që të dëgjosh të huajt të çuditur që pyesin se si ka mundësi që opozita juaj përçmon atdheun e vet teksa dëgjon Lulzim Bashën

kur flet 'il problema, il problema', - theksoi Rama. Kryeministri ka rrëfyer edhe dy kërkesa të veçanta që i kishin kërkuar Bashës gjatë marrëveshjes së 17 majit 2017. "Kur nënshkruam me Bashën marrëveshjen, i kërkova dy gjëra, rezultati nuk kontestohet dhe Shqipëria nuk shahet në gjuhë të huaj, por u desh një sezon veror që të dyja këto pikat avulluan dhe avazi rifilloi. Kontestohet fitorja e thellë e PS-së, sepse një tjetër humbje e thellë po afrohet për PD-në dhe simotërën e saj LSI-në, e cila është mishëruesja e fenomenit të shit-berjes së votave. Po të mos kishte LSI nuk do të kishte shit-berje të votave në Shqipëri", - deklaroi Rama.

regjimin e Edi Ramës të mbaruar, duke iu referuar si një kufomë që pret të kallet. Për këtë, tha Basha, duhet një reformë e thellë kushtetuese dhe elektorale por mbi të gjitha vullneti politik. "Meqë pyetët për formulën, hetim i plotë i dosjes 339, dosjes 184 dhe çuarja para përgjegjësive penale e politikanëve që kanë vjedhur votat bashkë me

krimin e organizuar janë po aq të rëndësishme, mos të them më të rëndësishme sesa ndryshimet në ligj që shkruhen dhe pastaj nuk zbatohen. Kur kjo të ndodhë mund të themi se drejtësia po bën punën dhe jo si sot ku donikaprelizimi e ka shndërruar atë në një bisht dhelprë për Edi Ramën të të cilin fshih dhe bën propagandë. Së dyti u jep besim sh-

qiptarëve se në zgjedhjet e ardhshme qdo politikan që pranon të ulet me kriminelët për të tjetërsuar vullnetin e tyre do të shkojë para drejtësisë dhe prapa hekurave", tha z.Basha. Edhe pas takimit me Danielsson, Basha nuk bëri asnjë hap pas nga vendimi për vijimin e protestave deri në rrëzimin e qeverisë. "Regjimi i Edi Ramës ka mbaruar, shqiptarët e kanë



Takimi i djeshëm i opozitës me drejtorin e Përgjithshëm për Politikën Europiane e Fqinjësisë dhe Negocimet e Zgjerimit, Christian Danielsson

Duncan pret Metën: Roli i Britanisë, kyç për stabilitetin në Ballkan

Gjatë vizitës së tij në Britaninë e Madhe, Presidenti Ilir Meta u prit dje nga Sir Alan Duncan, ministër për Europën e Britanisë së Madhe. "Shqipëria beson në angazhimin e domosdoshëm të Britanisë së Madhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor edhe pas Brexitit", - theksoi Presidenti Meta, "pasi, vendi juaj ka një rol kyç në këto dekada për forcimin e stabilitetit në Ballkan". Ministri Duncan dhe Presidenti Meta ndanë qëndrime të njëjta mbi zhvillimet në rajon, progresin historik të Maqedonisë së Veriut si dhe për rëndësinë e dialogut Kosovë-Serbi, që të konkludojë në arritjen e një marrëveshjeje që do të forcojë stabilitetin dhe të ardhmen europiane të gjithë rajonit. Ministrin Duncan siguroi Presidentin Meta se Britania e Madhe do vijojë të jetë prezente në Shqipëri dhe në rajon me qëllim të konsolidimit të demokracisë dhe shtetit ligjor. Duke vlerësuar rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit në fushat e sigurisë, të luftës kundër krimit të organizuar dhe sundimit të ligjit, Presidenti Meta theksoi rëndësinë e rritjes së bashkëpunimit ekonomik e tregtar midis dy vendeve në të ardhmen në nivele më të larta.



përcaktuar rrugën në të cilin do të ecet. Europa në të cilën duam të shkojmë nuk ka aleat më të mirë, garanci më të madhe se PD, aleatët e saj dhe qytetarët me të cilët do të vazhdojmë betejën deri në çlirimin e Shqipërisë nga krimi", theksoi z.Basha. Kreu i opozitës shmangu edhe interesin e medias lidhur me uljen në një tryezë dialogu me mazhorancën me

ndërmjetësimin e Presidentit Meta. Basha e mbylli prononcimin e tij për gazetaret me bindjen se ditë më të mira për Shqipërinë do të vinë. Për këtë kërkoi edhe konfirmimin e aleatës Kryemadhi e cila u shpreh: Patjetër që po! "Nuk jam këtu për të bërë rol in e analistit. Ditë më të mira për Shqipërinë do të vijnë. Apo jo zonja Kryemadhi?", u shpreh z.Basha.




Zyrtari i lartë i BE-së takon Ramën dhe Bashën: Nuk ka sinjale për dialog

Danielson: Djegja e mandateve minon integrimin e Shqipërisë

“Hapja e negociatave, nëse luftoni krimin e korrupsionin”

Valentina Madani

Brukseli përmes zyrtarit të lartë Christian Danielson as dhe nuk mundi të bindë palët politike në Tiranë se dialogu është e vetmja zgjidhje për kapërcimin e krizës që përjeton vendi. Drejtori i Përgjithshëm për Politikën Europiane e Fqinjësi dhe Negocimet e Zgjerimit, Christian Danielson pasi takoi kryeministrin Edi Rama dhe kreun e opozitës Lulzim Basha nuk fshehu dje shqetësimin para mediave. “A dëgjova ndonjë gjë unë sot që tregon apo të çon drejt përfundimit të bojkotimit? Jo, përgjigja është jo, nuk e dëgjova një gjë të tillë”, theksoi z. Danielson. Por ai këmbëngul në ndryshimin e këtyre qëndrimeve në mënyrë të veçantë të opozitës duke e këshilluar se zgjidhjet e duhura për vendin vijnë nga salla e parlamentit e jo në rrugë. “Sa i përket opozitës unë kam theksuar që vendimi i anëtarëve të opozitës për të dëgjur mandatet parlamentare, minon në mënyrë serioze rrugëtimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Pasiguria duhet të jkaluar në formë urgjente dhe jeta normale demokratike e vendit duhet restauruar. Parlamenti është shtyllë e shtetit, është motori i çdo demokracie të përkohshme, duhet të jetë vendi ku diferencat politike diskutohen dhe çohen përpara duke krijuar kushtet për një dialog konstruktiv në kuvend”, shpreh zyrtari i lartë i BE-së. Ai shmangur komentet mbi legjitimitetin e parlamentit me krijimin e asaj që kryeministri i cilëson si opozita e re. “Institucioni i parlamentit është i domosdoshëm. Të gjithë duhet ta luajnë aty rolin e vetë”, theksoi ai.



Zyrtari i lartë i BE-së, Christian Danielson, dje me kryeministrin Edi Rama

azil. “Historiku i Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Operacionet e ligjit kanë vazhduar dhe kemi parë disa vendime kundër krerëve të bandave. Përpjekjet duhet të vazhdojnë për të gjithë ato elementë që u përdorën në qershorin e vitit të shkuar jo vetëm reformës në drejtësi. Në të njëjtën kohë përpjekjet e tjera janë të rëndësishme si e drejta e pronësisë dhe e drejta e pakicës, si dhe për t'i dhënë fre aplikimeve të pabazës në azil. Ftesa që bëj sot për të restauruar një mjedis më konstruktiv politik që kjo thirrje të dëgohet dhe zhvillimet të shkojnë në këtë drejtim pasi do ishte më mirë për rrugëtimin drejt BE-së”, - u shpreh Christian Danielson.

DREJTËSIA

Drejtori i Përgjithshëm për Fqinjësi dhe Zgjerim në Bashkimin Evropian, Christian Danielson sapo mbërriti në Tiranë, e nisi axhendën e tij pa humbur kohë, me Këshillin të Emërimeve në Drejtësi. Në një njoftim në Twitter ai shkruan se është takuar me anëtarët e KED, duke shtuar se në këtë takim BE mbështet reformën në drejtësi, e cila, siç tha, është kyç për progresin në BE. “Implementimi i reformës në drejtësi po ecën përpara. Kyç për rolin e ligjit në Shqipëri dhe për përpërimin e vendit drejt Bashkimit Evropian”, shkruan ai. Sikundër dhe pritet, kriza politike mori fokusin kryesor të diskutimeve të zyrtarit të lartë të BE-së, Christian Danielson, në takimin që pati me shefin e qeverisë Edi Rama. Drejtori i Përgjithshëm për politikën evropiane, fqinjësi dhe negociimet e zgjerimit në një postim në Twitter shkruan: “Bisedë shumë e hapur me kryeministrin Edi Rama mbi situatën aktuale politike dhe reformat. Danielson theksoi se Shqipëria duhet të çojë përpara të gjitha reformat, në veçanti luftën kundër krimit dhe korrupsionit, në mënyrë që të jetë bindëse në qershor, kohë kur shtetet anëtare të BE-së do të shqyrtojnë progresin e bërë dhe ku pritet një datë për hapjen e negociatave.

RAPORTI

Drejtuesve të mazhorancës e opozitës u kujtoi se qershori nuk është larg dhe, nëse kjo situatë pasigurie nuk tejkalohet, Kristian Danielson u kujtoi se do të pasqyrohet në raport duke rrezikuar seriozitetin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

AMBASADORI

Porositë e Danielsson, Soreca: S'duhet të bien në vesh të shurdhët

Ambasadori i BE në Shqipëri, Luigi Soreca komenoi dje situatën politike në vend. Pas vizitës së zyrtarit të lartë të Brukselit, Christian Danielsson, ambasadori Soreca shprehet se duhet dëgjuar ftesa për rivendosjen e një mjedisi politik konstruktiv. Ambasadori i Bashkimit Evropian në Tiranë, Luigi Soreca në përfundim të takimeve të Christian Danielsson në Shqipëri me aktorët politikë kërkoi që apeli i tij të mos bjerë në vesh të shurdhët, por të dëgohet për zgjidhjen e konfliktit. “Shpresoj që të gjithë qytetarët e Shqipërisë, që ftesa jonë për të rivendosur një mjedis politik më konstruktiv, të mos mbetet i padëgjuar. Ky është një mision i përbashkët kombëtar. Danielsson përfundon një vizitë shumë intensive dhe konstruktive një-ditore në Tiranë”, deklaroi ambasadori i BE-së në Tiranë. Soreca ishte i pranishëm dje në të gjitha takimet e Christian Danielsson, ku u diskutua përveç të tjerash edhe situata politike në vendin tonë.



MANDATET

“Kam theksuar që vendimi i anëtarëve të opozitës për të dëgjur mandatet parlamentare në bllok minon në mënyrë serioze rrugëtimin e Shqipërisë drejt integritetit në BE. Pasiguria duhet të jkaluar në formë urgjente dhe jeta normale demokratike duhet restauruar”, tha zyrtari i lartë i BE.



DIALOGU

“A dëgjova ndonjë gjë unë sot (dje) që tregon apo të çon drejt përfundimit të bojkotimit? Jo, përgjigja është jo, nuk e dëgjova një gjë të tillë”, - theksoi Drejtori i Përgjithshëm për Politikën Europiane e Fqinjësi dhe Negocimet e Zgjerimit.

PROTESTAT

Drejtori i Përgjithshëm për Politikën Europiane e Fqinjësi dhe Negocimet e Zgjerimit, Christian Danielson bëri thirrje dhe për të mos nxitur dhunën. “Është e rëndësishme që protestat të jenë të paqme dhe që ata që janë përgjegjës për të të përmbahen dhe të mos nxisin dhunë. Kjo është theksuar dhe nga Mogherini dhe Hahn. Nxitja e dhunës është shqetësim i madh për ne”, - u shpreh z. Danielson. Gjithashtu, kërkohet dhe plotësimi i vendeve vakante të Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartë. “Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është një gur i rëndësishëm dhe rritësojmë mbështetjen e plotë, paanshmërinë e tij. Kjo pavarësi duhet ruajtur në të gjitha fazat e saj. Dhashë shpresën që ky këshill të merret me

vendet vakante sa i takon Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të lartë si përparësi”, deklaroi z. Danielson. Ai bëri të ditur se është i fokusuar tek përgatitja e progres raportit për vendin tonë, por nuk zbuloi më shumë se kaq mbi qëndrimin që do të mbajë Komisioni Evropian për hapjen e negociatave për Shqipërinë.

APELI

Zyrtari i lartë i BE-së apelin e fundit e kishte për restaurimin e një mjedisi konstruktiv politik i cili do t'i jepte fre dhe aplikimet për

Medar KAJOLLI Përmbareus Gjyqësor Privat me seli në Rr. "Urani Pano" Pll.1/3, Kati-2, Tiranë, nxjerr ne shitje ne ankand pasurite e paluajtshme si me poshte:
 - Nr.Regjistrat Hipoetkor 717, datë 12.10.2018, me Sllp.-200 m2, Zk. 3844, Lloji Dyqan Shitje Industriale, ndodhur në Vuno, Bashkia Himarë, Cariku Vlorë, me vlerë 4,151,280 (Kater milion e njiqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë) LEKë.
 - ne pronesi te debitorit Z. Spiro Ekonomi.
 Shitja e pasurive te paluajtshme do te behet (Zhvillohet) ne date 11.03.2019, ditën e Hënë, ora 16.00 ne Zyren e Përmbareusit Gjyqësor Privat Z. Medar KAJOLLI, ne Adresen Rrugën "Urani Pano", Pll.-1/3, Kati-2, Tiranë.
 Per informacione mund te kontaktoni
 Nr.Tel:+355 66 20 333 03, ose ne Adr.-email:medar.kajolli@yahoo.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
 Përmbaremi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përmbareuse Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e pare për pasurine :
 1- "Trull", me sipërfaqe 250 m2 dhe sipërfaqe ndërtese 85m2, e ndodhur në Bërrinçë, Devoll, në Zonën Kadastrale 1202, Numri i Pasurisë: 1831/50, Vol. 23, Faqe. 70, në pronesi te Vasil Ferit Mucëku. Çmimi me të cilin filloj shitja e kësaj pasurie është në vlerën 8,000 (ete mijë euro) EURO ose 1,000,000 (nje milion) LEKË.
 Ankandi i pare per pasurine e mesiperme zhvillohet me datë 15.03.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës se përmbareuse gjyqesore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr."Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 069381883 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
 Përmbaremi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përmbareuse Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e trete për pasurine :
 1-"Are", me sipërfaqe 1,200 m2, e ndodhur në Katund i Ri, Tiranë në Zonën Kadastrale: 2119, Numri i Pasurisë: 97/1/1, Vol. 2, Faqe. 197/61 ne pronesi te Albert Seadin Duka. Çmimi me të cilin filloj shitja e kësaj pasurie është në vlerën 19,152 (netetëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) EURO ose 2,394,000 (dy milion e treqind e netetëdhjetë e e kater mijë) LEKË.
 Ankandi i trete per pasurine e mesiperme zhvillohet me datë 01.04.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës se përmbareuse gjyqesore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr."Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 069381883 .

Pandeli Majko "refuzon" postin e kryeministrit të qeverisë tranzitore

Pandeli Majko ka "refuzuar" dje postin e kryeministrit të qeverisë tranzitore. Ndonëse nuk ia ka ofruar askush deri më tani, pasi mazhoranca dhe qeveria ku ai bën pjesë nuk ka pranuar ta marrë fare në konsideratë kërkesën e opozitës për qeveri tranzitore dhe zgjedhje të parakohëshme. Majko ndërsa është përfshirë në një debat publik me gazetarin Mero Baze, ka bërë të ditur se nuk do e pranonte ta luante sërisht rolin e një "kryeministri dezhurn", siç njihet

ai për shkak se ka drejtuar më parë qeveritë socialiste vetëm në kohë krizash. Kështu në një koment të tijin Baze shkruante se "Lulzim Basha do zgjedhje, i do tani, i do pa Edi Ramën dhe do që të caktojë dhe një kryeministër që e pranon ai, në këtë rast Pandeli Majkon, me siguri ngaqë ka dëgjuar kur ka qenë emigrant se ai është kryeministër

dezhurn, sa herë është nevojë", duke aluduar se opozita ka kërkuar që qeveria tranzitore të ketë Majkon kryeministër. Nisur pikërisht nga ky aludim, ky i fundit në një reagim në rrjetet sociale shprehet se "artikulli nuk është në 'ajër' pasi pena e Bazes nuk ngyen në bojën e imagjinatës", duke lënë të kuptohet se ajo çka thuhet në këtë koment kishte baza të

vërteta. Gjithsesi ai e hedh poshtë këtë aludim, duke lënë të kuptohet se nuk do e pranonte një propozim të tillë. "Në ditë të tilla, nuk më ka marrë malli të bëj gjëra të cilat i kam përbuzur që ditën që i kam hyrë politikës. Roli i "delfinit" është një kostum, i cili nuk më është përshatur në politikë. Kam bërë "dezhurn" (siç shkruan Baze) që 30 vjeç në



Pandeli Majko

zyrën e kryeministrit të Shqipërisë, jo për "fajin" tim. Titullin "kryeministër i socialistëve" e konsideroj një nder, të cilin nuk kam ndër-

mend ta shkëmbej në zarin e maskave të politikës. Ditët e vështira i konsideroj provë për besimin dhe jo bukskalësinë", shkroi Majko.

Kuvendi shmangu fjalimin e presidentit sloven në seancën e 5 marsit për shkak të protestës

Mandatet, mazhoranca refuzon nismat ligjore që ka paraqitur opozita

"Nismat e propozuara nga opozita nuk qëndrojnë më"

Pas dorëzimit të mandatit të deputetëve, mazhoranca ka vendosur të mos e marrë më në konsideratë opozitën reale që tashmë është larguar nga Kuvendi. Ajo prej disa ditësh ka braktisur çdo tryezë debati mediatiq dhe publik ku të ftuar janë përfaqësues të PD dhe LSI, ndërsa ka vendosur, gjithashtu, që të mos njoh as kontributin e tyre të deritanishëm në jetën parlamentare. Kështu, socialistët nuk do të marrin më në shqyrtim as nismat ligjore që kanë paraqitur në Kuvend deputetët e opozitës dhe që ndodhen edhe në kalendar. Në fakt, sipas procesverbalit të publikuar nga Kuvendi, kjo çështje është bërë objekt diskutimesh në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të datës 26 shkurt, ku zëvendëskryetarja e komisionit të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, Milva Ekonomi ka kërkuar mendimin e drejtuesve të Kuvendit se si do të veprohej me këto nisma të depozituara më parë nga opozita. "Në Komisionin e Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik kemi diskutuar në parim një nisëm që ka ardhur nga Grupi Parlamentar i LSI-së, për ligjin e arsimit të lartë. Ndërkohë në komision janë kaluar edhe nismat e depozituara nga deputetët e LSI-së, si duhet të veprohet në këtë rast, t'i përfshijmë në kalendar apo t'i lëmë?", - mësohet nga procesverbalit të ketë pyetur Ekonomi. Përgjigjen për këtë shqetësim të saj e ka dhënë kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla, i cili ka bërë të ditur se këto nisma nuk do të shqyrtohen më për sa kohë që propozuesit nuk janë më deputetë. "Zonja Ekonomi është deputete e re. Ju informoj se, të gjitha




Konferenca e Kryetarëve

nismat të propozuara nga deputetët që kanë dhënë dorëheqjen nga mandati nuk qëndrojnë më dhe nuk janë pjesë e punës së Kuvendit. Rregullorja e Kuvendit dhe Kushtetuta e përcaktojnë qartë që, kur propozuesi nuk është më pjesë e parlamentit të gjitha këto projektakte të propozuara nga deputetët që nuk e gëzojnë më mandatin e deputetit, nuk janë më pjesë e shqyrtimit të punës së komisioneve dhe seancave plenare", - është shprehur Balla. Dy nga nismat që bien dhe

nuk do të merren në në shqyrtim nga Kuvendi janë edhe ato të paraqitura nga deputetët e LSI-së dhe që erdhën si reagim ndaj kërkesave të studentëve. E para që ka të bëjë me amendimin e Buxhetit të vitit 2019 dhe me anë të cilës propozohej të dyfishoheshin zërat për arsimin universitar dhe kërkimin shkencor, ndërsa nisma e dytë kërkonte të ndryshonte ligjin "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor" dhe të rriste në nivelin e 50% të përfaqësimit të studentëve në organet

vendimmarrëse të universiteteve. Po nga procesverbalit i kësaj mbledhje mësojmë edhe faktin se presidenti i Slovenisë, Borut Pahor ishte parashikuar që të fliste në seancën e datës 5 mars në sallën e seancave plenare. Por protesta e opozitës dhe situata e tensionuar jashtë Kuvendit duket se kanë bërë që të hiqet dorë nga ky plan. Këtë e ka bërë të ditur Gramoz Ruçi gjatë kësaj mbledhje, ku ka informuar anëtarët e Konferencës së Kryetarëve se sipas traditës presidenti Pahor do fliste në seancë. "Vë në vëmendjen tuaj se, është paraqitur kërkesë nga ambasadori i Slovenisë, ku ka shprehur interes që Presidenti i Slovenisë vijë në parlament në datën 5 mars. Tradita jonë ka qenë se të gjithë presidentët kanë kaluar në parlament, në këtë mënyrë të përputhet data e vizitës së tij më datën e seancës plenare, datën 5 mars 2019", - ka deklaruar Ruçi në fund të asaj mbledhje. Por pavarësisht kësaj, presidenti Pavor nuk foli në Kuvend, por u mjaftua me një takim të veçantë në ambientet e kryesisë me Ruçin. Çka lë të kuptohet qartë se prania e tij në seancë është anuluar për shkak të situatës konfliktuale jashtë ambienteve të Kuvendit, ku protestonte opozita.



Balla: Java tjetër intensive për plotësimin e vendeve në Kuvend

Situata aktuale politike si dhe përgatitjet për zgjedhjet lokale të 30 qershorit ishin në fokus të asamblesë së zgjeruar të degës së PS Pogradec. I pranishëm në këtë takim, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste, Taulant Balla u shpreh se prej 4 vitesh Pogradeci është në duar të gabuara. "Sot kemi fiks 120 ditë nga dita kur ne do t'i kthejmë Pogradecit dinjitetin, moralin, përgjegjëshmërinë dhe do t'i japim një kryetar bashkie, i cili të punojë për Pogradecin, jo për bizneset e të vëllait të kryetarit", - u shpreh i Sekretari i Përgjithshëm i PS Taulant Balla. Duke u ndalur në situatën e krijuar pas dorëzimit të mandateve nga opozita, Balla theksoi se PS është e gatshme të dialogojë, por kurrësi nuk mund të bëjë negociata në kurriz të demokracisë. "Plot djem e vajza shqiptarë të përgjegjshëm për të ardhmen e vendit do të marrin përgjegjësinë e përfaqësimit në Kuvend. Besoj se java e ardhshme do të jetë një javë intensive në këtë drejtim. Prandaj erdhem sot! Për t'ju thënë se ne nuk tërhiqemi, për t'ju thënë se zgjedhjet e përgjithshme do të jenë në vitin 2021, se Kuvendi ka legjitimitetin e duhur, se qeveria ka legjitimitetin e duhur dhe se jemi të gatshëm të dialogojmë me atë çfarë ka mbetur nga opozita në degradim. Kurrësi ne nuk mund të bëjmë negociata në kurriz të demokracisë", tha ai.

VIZITA
Vë në vëmendjen tuaj se, është paraqitur kërkesë nga ambasadori i Slovenisë, ku ka shprehur interes që Presidenti i Slovenisë vijë në parlament në datën 5 mars. Tradita jonë ka qenë se të gjithë presidentët kanë kaluar në parlament, në këtë mënyrë të përputhet data e vizitës së tij më datën e seancës plenare, datën 5 mars 2019", - ka deklaruar Ruçi

SHPLLJE ANKANDI
Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoa, Pall 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 05.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr 5/264/ND-1-2, ZK. 8250, me sipërfaqe 137 m² me adresë Tiranë, në pronësi Z.Bujar Musa Kajtazi me vlerë fillestare në ankand 69,216 (Gjashhtëdhjet e nëntë mijë e dyqind e gjathtëmbëdhjetë) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 4 22 31 888.

NJOFTIM ANKANDI
1. Shoqëria e Përbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të III (tretë), për shlyerjen e pasurisë ULLISHTE , me sip.3.400 m², Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 32/71, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: Z.Bejram Selfer Skraçi, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën 1.713.600 (një milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e gjathtëqind) Lekë.
Ankandi do të zhvillohet më datë 12.03.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: shp@shp.com

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" SH.p.k
Rr. "Tish Dala", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë
Web: www.3h-sh.com; Email: shp@3h-sh.com; tel:0692099711
Njofton shpalljen e ankandit nga dt.28.02.2019 deri ne dt. 11.03.2019 per: sendin e luajtshem mjeti me targe DR 9619 D ne pronesi te Hynsi Gjergji Cmimi fillestar eshte 800 EURO
Ankandi zhvillohet ne zyrën përbarimore ne daten 11.03.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

Ligji i ri: Pas 20 marsit deri më 20 prill, paguhet vetëm tarifa e regjistrimit, falen kamatëvonesat

"Amnisti" për hipotekimin e pronave deri më 20 prill

Hyn në fuqi ligji për kadastrat si do të regjistrohen pasuritë

Personat që kanë pronë për të regjistruar dhe kanë shkelur afatet ligjore mund ta kryejnë regjistrimin deri më 20 prill duke përfutur kështu faljen e kamatëvonesave. Hyrja në fuqi e ligjit të ri për krijimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës do të sjellë edhe një "amnisti" për pronat e paregjistruara në zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në ligjin e mëparshëm parashikohej se, nëse një kërkesë për regjistrim paraqitej më vonë se 30 ditë nga data e realizimit të tij, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesë, që ka kaluar nga kjo datë, paguhej kamatëvonesë, e barabartë me 10 për qind të tarifës së regjistrimit, por jo më shumë se 300 000 lekë. Me ligjin e ri, parashikohet se të gjitha kamatëvonesat e gjeneruara nga sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, pra deri më 20 mars, do të shuhen. Nga data 20 mars deri me datën 20 prill ata që kanë veç tarifës së regjistrimit të pasurisë kanë edhe kamatëvonesë, do të mund të bëjnë regjistrimin duke paguar vetëm tarifën e regjistrimit, pasi kamatëvonesa u falet. Ligji i ri që parashikon shkriren e Agjencisë së Legalizimeve, Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme



Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

REGJISTRIMI I KONTRATËS SË SHITJES

1. Kontrata e shitjes për një pasuri të paluajtshme regjistrohet në seksionin përkatës të kartelës kadastrale, pas verifikimit të elementeve të formës e të përmbajtjes së aktit noterial, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Shitja e pasurisë së paluajtshme private bëhet vetëm me akt noterial, të hartuar sipas kërkesave të Kodit Civil dhe të legjislacionit për noterinë.
3. Drejtoria vendore i krijon të gjitha lehtësitë noterit gjatë fazës së hartimit të kontratës së shitjes. Noteri mund të aplikojë për marrjen e informacionit kadastral mbi pronën, objekt shitjeje.
4. Agjencia bën publike të gjitha kërkesat që duhet të plotësojë pronari ose personi i interesuar për të regjistruar kontratën e shitjes.
5. Kontrata paraprake e shitjes regjistrohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

dhe Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike është publikuar në Fletoren Zyrtare duke i hapur rrugë në këtë mënyrë nisjes së procesin konkret. Ligji i ri parashikon krijimin e Agjencisë

Shtetërore të Kadastrës. Kjo Agjenci duhet të krijohet jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, çka nënkupton se ngritja duhet të bëhet deri më 20 prill.

CERTIFIKATAT

Sipas ligjit të ri drejtoria

vendore, në përfundim të regjistrimit fillestar ose pas regjistrimit të çdo kalimi pronësie nga një pronar te një tjetër, lëshon certifikatën e pronësisë. Certifikata e pronësisë është dokumenti unik i papërsëritshëm që provon titullin e pronësisë, statusin ligjor dhe kufijtë e pronës. Sipas ligjit Certifikata e pronësisë i lëshohet vetëm personit pronar ose bashkëpronarëve. Në rastin e bashkëpronësisë certifikata hartohet në aq kopje sa është numri i bashkëpronarëve.

Nërkohë certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar. Sipas ligjit Certifikata e pronësisë, bashkëpronësisë lëshohet mbi bazën e një dokumenti ligjor origjinal që përcakton krijimin e këtyre të drejtave. Një certifikatë e lëshuar në kundërshtim me këtë parashikim

konsiderohet absolutisht e pavlefshme. Nërkohë lëshohet certifikatë dhe për vërtetimin e të drejtave të tjera reale mbi pasurinë e paluajtshme, si: qiraja, enfitheoza, përdorimi, uzufrukti, servituti, hipoteka etj. Modeli i certifikatës së pronësisë dhe i certifikatave për të drejtat e tjera reale mbi pasurinë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Certifikatat që lëshohen jashtë modelit të miratuar nuk kanë asnjë vlerë ligjore.

FUSHA E VEPRIMIT NË KËTË LIGJ, PËRCAKTOHEN RREGULLA PËR:

- a) organizimin e regjimit kadastral të shtetit;
- b) regjistrimin e pronave të paluajtshme private, shtetërore dhe publike, të të drejtave reale mbi to;
- c) përmirësimin/përditësimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme;
- ç) krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

KËRKESA DHE AFATET

1. Çdo shërbim kadastral kryhet vetëm pas dorëzimit të një kërkesë. Kërkesa është një formular tip që gjendet në sportelet e shërbimit ose on-line. Modeli i kërkesës miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme, sipas llojit të shërbimit që kërkohet.
2. Agjencia publikon të gjitha llojet e shërbimeve që kryen kadastra, formularin e kërkesës përkatëse dhe dokumentacionin shoqërues të kërkuar për çdo shërbim. Publikimi duhet të jetë i dukshëm dhe i arritshëm për çdo shtetas.
3. Çdo kërkesë për shërbim kadastral, që paraqitet rregullisht, trajtohet brenda 15 ditëve nga data e depozitimit, por në çdo rast jo më vonë se 21 ditë kalendarike.
4. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për procedurën e trajtimit të kërkesave.

Kategoritë që përfitojnë

Drejtoria e Transporteve rrit pagat për punonjësit në Tiranë dhe në rrethe

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Krugor njofton rritjen e pagave për disa kategori punonjësish në qendër dhe në drejtoritë rajonale. Referuar njoftimit, në Drejtoritë Rajonale ka një rritje nga ndryshimi i përqindjes së shtesës së kategorisë prej 5% në drejtoritë rajonale: Durrës, Elbasan, Fier, Shkodër, Laç, Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kukës, Sarandë. Sipas vendimit për pozicionin Kryetar Dege Financë ka një rritje maksimale bruto prej 4.300 lekë, për pozicionin Përgjegjës Sektori Financë ka një rritje maksimale bruto prej 4.300 lekë. Ndërkohë për pozicionet Kryetar Dege Regjistrimi Mjete; Kryetar Dege/Specialist regjistrimi; Kryetar Dege/Specialist testimi ka një rritje maksimale bruto prej 3.000 lekë. Ndërsa për pozicionet:



Përgjegjës Sektori i Taksave Tirana 1; Taksave Tirana 2; Përgjegjës Sektori i Jurist; Përgjegjës Sektori Juridik dhe Burimeve Njerëzore ka një rritje maksimale bruto prej 2.000 lekë. Sipas tabelës mësohet se për pozicionet: Specialist administrimi; testimi; regjistrimi; regjistrimi/identifikimi; identifikimi/tahografi; regjistrimi/identifikimi/tahografi; Ekonomist; Jurist; Jurist/specialist ndryshim pronësie mjete,

ka një rritje maksimale bruto prej 2.000 lekë, dhe për Drejtorinë e Përgjithshme është hequr kategoria 5/a1 dhe është bashkuar me kategorinë 5/a, pra për specialistët e sektorit të financës, planifikimit ekonomik, administrimit në këtë kategori ka një rritje maksimale bruto prej 2.000 lekë. Ndërsa për kategoritë 5/b dhe 5/c është rritur vështirësia nga 10.000 lekë në 12.000 lekë, pra për specialistët e kësaj kategoritë në sektorin e regjistrimit të mjeteve dhe Tahografit; licencimit, certifikimit dhe ATP; drejtuesve të mjeteve; kontrollit të autoskollave; kualifikimeve; testeve; prokurimeve; juridik, arkivit kombëtar të mjeteve; arkivit kombëtar të drejtuesve të mjeteve; shërbimeve mbështetëse; informacionit, kanë një rritje maksimale bruto prej 2.000 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPERISE BANKA E SHQIPERISE DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Realizimi i lidhjes online ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 9,720,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibërës, Kompleksi "Haliil", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktëshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Realizimi i lidhjes online ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **01 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

TIRANË

Vrasje për drogë dhe prostitucion, ja e shkuara e errët e Armando Gorezit

Sekuestrohet pasuria me vlerë 2.2 milionë euro e 2 vëllezërve Gorezi në Tiranë dhe Durrës

Policia: Dyshohet se nëntë apartamentet, dyqanet dhe garazhet janë përfituar nga aktiviteti kriminal

Nëntë apartamente, dy dyqane dhe një garazh në pronësi të vëllezërve Armando dhe Alket Gorezi janë vënë në sekuestro preventive, pasi dyshohet se janë përfituar nga aktiviteti kriminal. Sipas Burimeve zyrtare nga Policia e Shtetit, pasuria e këtyre shtetasve kap shifrën 2.2 milionë euro. Mësohet se pas një hetimi të shtrirë në kohë, u bë e mundur identifikimi i këtyre pasurive të dyshimta në Tiranë dhe Durrës. Vërtetimi i paligjshmërisë së pasurisë është kryer me metoda speciale, ndërsa në fund organet kompetente vendosën të ekzekutojnë vendimin e gjykatës për të sekuestruar pasuritë e mësipërme, pasi vlerat financiare dhe ekonomike nuk justifikoheshin nga dy vëllezërit Gorezi. "Finalizohet operacioni i koduar 'Vilazëria' nga Seksioni Pastrimit të Parave në DVP Tiranë, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sekuestrohen nëntë apartamente, dy dyqane dhe një garazh, dyqanet këto të dyshuara të përfituara nga të ardhura nga aktiviteti kriminal. Seksioni Pastrimit të Parave në DVP Tiranë, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në funksion të procedimit penal të vitit 2018 "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", në ngarkim të shtetasve Armando Gorezi, 44 vjeç dhe Alket Gorezi 47 vjeç (vëllezër), finalizoi operacionin policor të koduar 'Vilazëria', thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërsa sqarohet në njoftim se "në kuadër të këtij operacioni u bë ekzekutimi i vendimit të gjykatës dhe sekuestrimi preventiv i nëntë apartamenteve, dy



Armando Gorezi

dyqaneve dhe një garazhi (të ndodhura në qytetin e Tiranës dhe Durrësit, të cilat kapin vlerën e dy milion e dyqind mijë euro). Pas një pune disa mujore në funksion të procedimit të regjistruar duke përdorur metoda speciale të hetimit, janë identifikuar pasuritë, të cilat nuk justifikoheshin nga ana ekonomike e financiare dhe rridhin nga aktiviteti kriminal i dy vëllezërve. Aktualisht dy vëllezërit Gorezi, të cilët jetojnë prej vitesh në Tiranë, po hetohen në gjendje të lirë.

KUSH JANË DY VËLLEZËRIT

Njëri nga dy vëllezërit Gorezi që iu sekuestrua dje pasuria nuk është emër i panjohur për Policinë e Shtetit dhe për atë italiane. Bëhet fjalë për Armando Gorezin nga Berati, i cili ka qenë i arrestuar më parë pasi dyshohej si i përfshirë në një vrasje në Itali. Armando u ekstradua drejt Italisë më 29 korrik 2015. Ai ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar më 9 shkurt 2015 dhe ishte dënuar në mungesë me 12 vite burg. Më 6 maj 2014, Gjykata e Torinos në Ita-



Policia e Shtetit

li kishte lëshuar urdhrë arresti ndaj Gorezit për veprën penale të vrasjes. Bëhet fjalë për një ngjarje të ndodhur më 6 gusht 2011 në Torino, kur u vra Indrit Kuçi. Armando Gorezi ishte i dyshuar si autor i vrasjes, sepse disa ditë para krimi, viktimë kishte rrahur Armando Gorezin, sipas raportimeve të shtypit italian në atë kohë. Por në janar të vitit 2017, edhe pse ishte dënuar në mungesë me 12 vite burgim për vrasjen e shqiptarit Kuçi, një gjykatë e apelit në Itali e shpalli të pafajshëm Armando Gorezin dhe e liroi nga të

gjitha akuzat pasi nuk kishte prova të mjaftueshme për ta shpallur fajtor. Gjithashtu, mësohet se në vitin 2015, prokuroria e Beratit kishte rifilluar një hetim në gjendje të lirë ndaj Armando Gorezit për trafik të genieve njerëzve, pasi dyshohet se kishte trafikuar një grua me iniciale E.K., e cila është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Tirana si person i humbur. Burimet thonë se pasuria e vëllezërve Gorezi dyshohet se është përfituar nga aktiviteti kriminal i prostitucionit dhe trafikut të drogës.

SHKURT

I dënuar me 6 vite burg në Itali, pranga 65-vjeçarit

FIER - Policia e Fierit në bashkëpunim me Departamentin e Policisë Kriminale dhe Interpol Tirana kanë bërë të mundur arrestimin e 65-vjeçarit Kujtim Xhufi, i cili rezultonte i shpallur në kërkim ndërkombëtar. Sipas policisë, i arrestuari rezultoi i dënuar nga gjykata e Breshias në Itali me 6 vite burg për veprën penale pjesëmarrje në organizatë kriminale. "Arrestohet përkohësisht një shtetas shqiptar i shpallur në kërkim ndërkombëtar, me qëllim ekstradim drejt Italisë. Specialistët për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafikeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, në bashkëpunim me Interpol Tirana, arrestuan përkohësisht shtetasin e shqiptar të shpallur në kërkim ndërkombëtar: K.Xh., 65 vjeç, banues në Fier. Kapja e këtij shtetasi u bë pasi Gjykata e Breshias, Itali, e ka dënuar me 6 vjet burg për veprën penale "Pjesëmarrje në organizatë kriminale, me qëllim trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike", parashikuar nga Kodi Penal italian", njofton policia.

Rinas, arrestohet vlonjati

ME DY KARTA IDENTITETI RUMUNE TIRANË - Policia Kufitare e Rinasit ka prangosur një 26-vjeçar për tentativë të kalimit të masave shtesë për parandalimin e dokumenteve të falsifikuara. Mësohet se në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë, gjatë përpunimit të dokumentacionit të shtetasve në dalje nga Republika e Shqipërisë, në kuadër edhe të aplikimit të masave shtesë për parandalimin azilkërkimit, blutë kanë bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit: S.H., 26 vjeç, banues në Vlorë. Arrestimi i tij u bë, pasi gjatë kontrollit fizik policia i gjeti dhe i sekuestrroi dy karta identiteti rumune, të cilat dyshohen të falsifikuara. Materialet i kaluan prokurorisë për veprime të mëtejshme për veprën penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave".

Gjendet trupi i dekompozuar i një mashkulli në Currila

DURRËS - Një trup mashkull i dekompozuar është gjetur dje në zonën e Currilave në Durrës. "Rreth orës 10:30, në lagjen nr.1, Currila, Durrës, është gjetur një kufomë e rregullt nga ana strukturore, por e dekompozuar. Nga hetimet e para dyshohet të jetë e seksit mashkull dhe nuk janë konstatuar shenja dhune. Grupi hetimor në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, po punon për identifikimin e kufomës dhe zbardhjen e plotë të shkakut të vdekjes", njofton policia.

Reagon Tritan Shehu: E patolerueshme, krim i vërtetë!

Dhunohen dy mjekë në krye të detyrës në Tiranë dhe Lezhë, QSUT: Dënojmë aktin, rast i përsëritur

Nuk ka të ndalur dhuana ndaj bluzave të bardha. Dy raste të dhunimit të mjekëve janë shënuar në Lezhë dhe në Durrës. Mësohet se ditën e djeshme është dhunuar mjeku dermatolog në spitalin e Lezhës, Zef Doda. Ai u godit me mjete të forta e për pasojë pësoi frakturat. Nisur nga gjendja e rëndë shëndetësore Doda është dërguar në spitalin e Traumës në Tiranë për ndihmë më të specializuar. Ndërkaq, në Tiranë raportohet të jetë dhunuar në Urgjencën Kirurgjikale në QSUT mjekja specializante V.Zyka. Rasti i mjekes së QSUT-së ka ndodhur mbrëmjen e së mërkurës, ndërsa është raportuar ditën e djeshme. Në lidhje me ngjarjen e parë kanë reaguar edhe demokrati Tritan Shehu dhe ish-deputetja e LSI-



REAGIMI I TRITAN SHEHU

"Një ngjarje e shëmtuar dhune e agresioni ndaj mjekëve ka ndodhur aktualisht në spitalin e Lezhës. Është agresuar mjeku dermatolog në ambjentet e spitalit, gjatë ushtrimit të detyrës së tij. E pa tolerueshme kjo, krim i vërtetë. Pasojë jo thjesht e problemeve të mëdha që ka sistemi i ynë shëndetësor, por dhe e një historie keqdashëse të drejtuar ndaj personelit të tij, pikërisht për të hedhur padrejtësisht përgjegjësitë mbi atë", shpreh ndër të tjera në një postim në rrjetet sociale, Tritan Shehu.

së Floida Kërpaçi, të cilët e quajnë të patolerueshme dhunën e ushtruar ndaj mjekëve. Ndërkaq, ka reaguar dhe Qendra Spita-



REAGIMI I FLOIDA KËRPACIT

"Një tjetër mjek goditet për shkak të detyrës! Përsëritja e këtyre akteve, tregon se nuk ka asnjë veprim nga shteti! Në vendin tonë, kjo qeveri më shumë mbeshtet kriminelët sesa mjekët! Pa rroga, pa vlerësim, pa mbështetje mjekët ashtu si mësuesit, të rinjtë po largohen nga vendi! Ikja e kësaj qeverie shpëton vendin dhe rikthen mjekët, mësuesit e shqiptarët në Shqipëri!", shkruan në rrjetet sociale ish-deputetja e LSI-së, Floida Kërpaçi.

lore Universitare duke dënuar aktin e dhunës së ushtruar ndaj mjekes specializante të Klinikës së parë të Kirurgjisë.



Mjeku dermatolog në spitalin e Lezhës, Zef Doda

REAGIMI I PLOTË I QSUT

Drejtorja e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", dënon rëndë aktin e dhunës së ushtruar nga një person i papërgjegjshëm, kundërshtues i mjekëve specializantë të Klinikës së parë të Kirurgjisë V.Z, gjatë ushtrimit të detyrës në Urgjencën Kirurgjikale. Një person i dehur, i papërgjegjshëm, i afërm i një pacienteje, e cila po merrte shërbim mjekësor, ka dhunuar mjekun dhe me pas është konfliktuar edhe me forcat e rendit, të cilët ushtrojnë detyrën e tyre në shërbimin e Urgjencës Kirurgjikale. Fatkeqësisht ky nuk është një

rast i izoluar, por është rast i përsëritur, që mjekët dhe infermierët të spitalit tonë dhunohen në krye të detyrës. Drejtorja e QSUT edhe një herë dënon aktin e dhunës të ushtruar ditën e djeshme ndaj personelit mjekësor dhe u bën thirrje organeve kompetente të zbardhin ngjarjen dhe autorët të marrin dënimin e merituar. Një apel të fortë i bëjmë opinionit publik, të mirëkuptojnë dhe përkrahin bluzat e bardha gjatë punës së tyre, të cilët pavarësisht situatave të krijuara, në asnjë rast nuk neglizhojnë misionin human, atë të dhënies së ndihmës së parë dhe shpëtimin e jetëve njerëzore.

Apeli i Krimeve të Rënda lë në fuqi datën 10 mars për mbylljen e hetimeve

Tahiri fiton "betejën" e radhës me prokurorinë, avokati: Do të kërkojmë pushimin e çështjes

"Organi i akuzës nuk ka prova për klientin tim"

IRANË

Ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri dje ka fituar një tjetër "betejë" me prokurorinë. Një javë pasi u mor i pandehur zyrtarisht, Tahiri dje zhvilloi përballjen e radhës me institucionin e akuzës. Mëngjesin e së enjtes i shoqëruar nga avokati Maksim Haxhia, ish-ministri i Brendshëm mbërriti në gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Kjo e fundit, shqyrtoi apelin e bërë nga prokuroria kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, që i kufizoi afatin e hetimit dhe urdhëroi t'i jepte zgjidhje çështjes brenda datës 10 mars. Ndërkaq, avokati Maks Haxhia, në një dalje për mediat deklaroi se prokuroria nuk ka prova se dhe ata do të kërkojnë pushimin e çështjes. Më 28 shkurt Prokuroria për Krime të Rënda mbylli hetimet dhe çoi dosjen e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri në Gjykatë me akuzën për "Trafikim të lëndëve narkotike" në kuadër të grupit të strukturuar kriminal "Habibaj" dhe "Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë". Pasi u njoh me akuzat Tahiri zgjodhi të komentojë me ironi se pas Aldo Bares ndoshta është i dyti me këtë akuzë. Ndonëse tha se do respektojë drejtësinë, ish-ministri tha se kjo pritej duke e cilësuar proces të turpshëm, politik e të komanduar. Tahiri nuk pranoi të thoshte se nga komandohet prokuroria në akuzat e ngritura ndaj tij, por tha se politika krimi dhe drejtësia janë aq bashkë sa ç'është dhe ati, biri dhe shpirti i shtetit.

REAGIMI I AVOKATIT MAKS HAXHIA

Avokati i ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri sqaroi se ditën e djeshme u paraqitën në Gjykatën e Apelit për e Krime të Rënda, pasi prokuroria kundërshtonte datën 10 mars për mbylljen e hetimeve për Tahirin. Sipas Haxhisë, Apeli i dha të drejtë Gjykatës së Krimeve të Rënda. Ndër të tjera, Haxhia tha se do të kërkojë pushimin i çështjes për Tahirin, duke u shprehur i sigurt se prokuroria nuk ka



Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, në Gjykatën e Apelit

asnjë "as" nën mëngë. "Sot çuditërisht kërkoi prapë kohë prokuroria me arsyetim, më vjen keq që po e them, se është shumë qesharake se duhet të respektohet e drejta e avokatit për të bërë një memo brenda 10 ditësh", tha ai. I pyetur nga gazetarët se nëse kjo kërkesë u duk kontradiktore, avokati pohoi: "Po shumë, megjithatë gjykata e

refuzoi dhe la në fuqi vendimin e shkallës së parë. Ndërsa, i pyetur nëse ka prova të reja për klientin e tij, ai u përgjigj: "Ne kemi marrë fashikujt e përgatitur nga Prokuroria që do t'i çohen gjykatës për të vlerësuar nëse çështja do shkojë në gjyq apo do pushohet. Ne do kërkojmë pushimin e saj. Prokuroria nuk ka asnjë "as" nën mëngë".

Gjendet kanabis i fshehur nën tokë, policia në kërkim të poseduesit

GJIROKASTËR - Policia e Gjirokastrës ka sekuestruar dje një sasi lëndë narkotike të fshehur nën tokë në një fshat, ndërsa është në kërkim të poseduesit të saj. Mësohet se mbi bazën e informacioneve të marra në rrugë operative se në një zonë të pyllëzuar një person kishte fshehur një sasi lëndë narkotike, blutë kanë organizuar punën dhe si rezultat i kontrollit në afërsi të fshatit Tërbuq, u gjetën 13.8 kg lëndë e dyshuar kanabis sativa e fshehur në tokë. Lëndë e dyshuar narkotike u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, ndërsa policia po punon për kapjen e autorit, ku për arsye hetimore nuk bëhen me dije të dhëna të tjera. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë për veprën penale "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike", parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal.

NJOFTIM ANKANDI

Përmaruesi Gjyqësor Privat Neritan Çuko, në datën 20.03.2019 ora 16:00 zhvilloi ankandin e Pare, për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Apartament me sipërfaqe 65 m², me numër pasurie 410/168/ND+1-19, në volumn 1, fage 110, hyrja 1, apartament 19, në zonen kadastrale nr. 2832, në Orikum, Vlore, në pronësi të Albert Sali Troqe, me debitor Tonin Troqe.

Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është EUR 23.200 (njeteze e tremije e dyqind euro).

Për çdo informacion mund të kontaktoni: Cel: Neritan Çuko: 0686065334; E-mail: neritancuko@gmail.com.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

NJOFTIM – SHPALLJE

PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E "VAKANCËS SË PARAKOSHME" TË KRIJUAR PËR VENDIN GJYQËR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, nënse 7/pika 2, 7/a, 7/b, 7/c/pika 2, kus pika 4 shkronja "c", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 9, datë 24.10.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, njoftuar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr. 380/4 prot, datë 29.10.2018, me cilësinë e organit të emërtesës, me qëllim plotësimin e "Vakancës së parakoshme", të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, dhe me cilësinë e organit të emërtesës me Dekretin nr. 10946, datë 09.11.2018, ka miratuar;

n Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për plotësimin e "Vakancës së parakoshme" të krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit, të ish-gjyqtarës Znj. Altina Xhoxhaj, sipas vendimit nr. 9, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Presidenti i Republikës fton;

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të hapur publik, për vakancën e mesipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës;

- Kërkesën për shpejtim e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/email);
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqërues nëpërmjet të cilit vërteton përbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit, është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Listë të dokumentacionit të dorëzuar, të firmosur nga aplikanti.

Për lehtësinë e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë gjë të botuar përbashkët e nenit 125, pika 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese,

■ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtarë të shpikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.
5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

■ Ligji nr.8577, dt 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 7/a

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përbush këto kushte:
 - a) të ketë zotësi të plote për të vepruar;
 - b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
 - c) të mos ketë ushtuar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
 - d) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale;
 - e) të mos jetë larguar nga detyra për shkak disiplinor dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - f) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:
 - a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
 - b) të ketë një veprimtarë të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
 - c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:
 - a) vjetërsisë në profesion;
 - b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese ose Gjykatës së Lartë;
 - c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
 - d) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
 - e) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlerëshme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimi përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
 - dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. Organet e emërtesës marrin parasysh përberjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjnore. Kërkesa dhe dokumentat shoqëruese mund të dorëzohet me postë ose drejtpërdrejtë në ambientet e Institucionit të Presidentit të Republikës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 26 nëntor 2018.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik, dhe menjëherë dosjet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparente çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr.8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:
Numri telefonit: 042389898

UFSH: Si do të procedohet për kandidatët përsëritës. Afatet e fundit sipas dosjeve

Voltiza Duro

Infermierët dhe farmacistët do të nënshtrohen provimeve të shtetit dhe atyre të aftësisimit praktik. Gazeta Shqiptare zbardh sot datat e dorëzimit të dosjeve nga ana e aplikantëve, datat e testimit si dhe dokumentacionin e plotë që duhet të paraqesin të interesuarit. Sipas Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, afati i fundit i dorëzimit të dosjeve dhe i regjistrimit për provimin e vlerësimit të aftësisimit praktik (VAP) është data 21 Mars 2019. Praktikantët që do të nënshtrohen provimit të VAP në mënyrë të përsëritur, duhet të paraqesin brenda datës 21 Mars 2019 kërkesën dhe mandatin e pagesës.

"Provimi i aftësisimit praktik (VAP) do të organizohet në ambjentet e UFSH, nga data 27 - 29 Mars 2019, sipas ndarjes së mëposhtme: data 27.03.2019 do të zhvillohet provimi për praktikantët me numër dosje 2920 - 2945; data 28.03.2019 do të zhvillohet provimi për praktikantët me numër dosje 2946 - 2970; data 29.03.2019 do të zhvillohet provimi për praktikantët me numër dosje 2971 - 2997 si dhe praktikantët që e kanë kryer praktikën në periudha të mëparshme", thekson UFSH. Ndërkohë, praktikantët që do të nënshtrohen VAP, duhet të paraqiten në orën 8:00 në ditën e provimit si dhe duhet të kenë me vete kartën e identitetit

PROVIMET E SH-TETIT
Regjistrimi i kandidatëve për provimin e shtetit të sezonit Maj 2019 do kryhet nga data 03 - 05 Prill 2019, pranë zyrave të UFSH Tiranë. Kandidatët që hyjnë për herë të parë në provimin e shtetit, duhet të dorëzojnë formularin e aplikimit, fotokopjen e kartës së identitetit, fotokopjen e noterizuar të diplomës universitare dhe listës së notave, si dhe fotokopjen e noterizuar të suplementit të diplomës. Gjithashtu, aplikantët duhet të paraqesin edhe një dëshmi të pjesëmarrjes në praktikën profesionale (lëshuar nga UFSH në momentin e kalimit me sukses të provimit të VAP); dëshminë e kursit të ndihmës së shpejtë (lëshuar nga Kryqi Kuq Shqiptar); raportin mjeko-ligjor; dëshminë e penaltetit; vërtetimin nga prokuroria e rrethit që individit nuk është në ndjekje penale; mandat pagesën në llogari të AKP; si dhe dy fotografi në format pasaporte.

KANDIDATËT PËRSËRITËS

Sakaq, Gazeta Shqiptare zbardh sot edhe dokumentacionin që duhet të dorëzo-

Zbardhen datat e provimeve të shtetit për infermierët e farmacistët

Dokumentacioni i plotë që duhet të dorëzojnë aplikantët



AFATI

Afati i fundit i dorëzimit të dosjeve dhe i regjistrimit për provimin e vlerësimit të aftësisimit praktik (VAP) është data 21 Mars. Praktikantët që do të nënshtrohen provimit të VAP në mënyrë të përsëritur, duhet të paraqesin kërkesën dhe mandatin e pagesës.

PËRSËRITESIT

Sakaq, Gazeta Shqiptare zbardh sot edhe dokumentacionin që duhet të dorëzojë nga kandidatët përsëritës për tu regjistruar për provim shteti. Përkatesisht ata duhet të paraqesin formularin e aplikimit, fotokopjen e diplomës universitare, fotokopjen e kartës së identitetit.

DOKUMENTACIONI PËR FARMACISTËT

Për kandidatët që regjistrohen për herë të parë në provim shteti

1. Formular aplikimi.
2. Fotokopje e kartës së identitetit.
3. Fotokopje e noterizuar e diplomës universitare dhe listës së notave.
4. Fotokopje e noterizuar e suplementit të diplomës.
5. Dëshmi e pjesëmarrjes në praktikën profesionale (lëshuar nga UFSH në momentin e kalimit me sukses të provimit të VAP).
6. Dëshmi e kursit të ndihmës së shpejtë (lëshuar nga Kryqi Kuq Shqiptar).
7. Raport mjeko-ligjor.
8. Dëshmi penaltetit.
9. Vërtetim nga prokuroria e rrethit që nuk është në ndjekje penale.
10. Mandat pagesa në llogari të AKP
11. 2 (dy) fotografi (format pasaporte).

Për kandidatët përsëritës

1. Formular aplikimi.
2. Fotokopje e diplomës universitare
3. Fotokopje e kartës së identitetit.
4. Raporti mjeko-ligjor.
5. Dëshmi penaltetit;
6. Vërtetim nga prokuroria e rrethit që nuk është në ndjekje penale;
7. Mandat pagesa në llogarinë e AKP
8. 2 (dy) fotografi (format pasaporte).

het nga kandidatët përsëritës për tu regjistruar për provim shteti. Përkatesisht ata duhet të paraqesin formularin e ap-

plikimit, fotokopjen e diplomës universitare, fotokopjen e kartës së identitetit, raportin mjeko-ligjor, dëshminë e penaltetit, vër-

DATAT E TESTIMIT PËR FARMACISTËT

Provimi i aftësisimit praktik (VAP) do të organizohet në ambjentet e UFSH, nga data 27 - 29 Mars 2019, sipas ndarjes së mëposhtme:

- Data 27.03.2019 do të zhvillohet provimi për praktikantët me numër dosje 2920 - 2945
- Data 28.03.2019 do të zhvillohet provimi për praktikantët me numër dosje 2946 - 2970
- Data 29.03.2019 do të zhvillohet provimi për praktikantët me numër dosje 2971 - 2997 si dhe praktikantët që e kanë kryer praktikën në periudha të mëparshme.

***Praktikantët që i nënshtrohen VAP, duhet të paraqiten në orën 8:00 në ditën e provimit si dhe duhet të kenë me vete kartën e identitetit**

DOKUMENTACIONI PËR INFERMIERËT

- Kërkesë për regjistrim në provim, ku do të përcaktoni saktë për të satën herë hyni në provim praktike. (shkarkoje këtu)
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave.
- Fotokopje e kartës së identitetit dhe kartës së praktikantit.
- Librezën e Praktikës (Ata që e kanë dorëzuar në sezona të mëparshme, por më pas nuk janë paraqitur në provim, duhet të specifikojnë në Kërkesë sezonin kur e kanë dorëzuar).

tetimin nga prokuroria e rrethit që personi nuk është në ndjekje penale, mandat pagesën në llogari të AKP; si dhe dy fotografi në

format pasaporte. "Raporti mjeko-ligjor, vërtetimi nga prokuroria dhe dëshmia e penaltetit duhet të jenë të lëshuara gjatë tre muajve të

fundit.

Kandidatët për t'u regjistruar duhet të paraqesin detyrimisht dëshminë e penaltetit, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Kandidatët që janë diplomuar në ish Universitetin "Kristal" duhet të paraqesin vërtetimin e vlefshmërisë së diplomës, lëshuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë", bën me dije Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë.

PROVIM PËR INFERMIERËT

Në datat 12,13, dhe 15 Mars 2019, do të bëhen regjistrimet për të gjithë ata që dëshirojnë të hyjnë në VAP Prill 2019 në profesionin e infermierit. "Për të krijuar mundësinë e pjesëmarrjes në provim, të gjithë kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë pranë zyrave ku kanë bërë regjistrimin në praktikë dokumentet e mëposhtme: kërkesë për regjistrim në provim, ku do të përcaktoni saktë për të satën herë hyni në provim praktike; fotokopje të diplomës dhe listës së notave; fotokopje të kartës së identitetit dhe kartës së praktikantit; si dhe librezën e Praktikës", thekson Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë. Ndërkohë, provimi VAP do të zhvillohet gjatë muajit Prill 2019, por për datat e sakta për secilin person që dorëzon librezën, duhet të kontrollohet faja e UISH online. Ata që e japin VAP në këtë sezon nuk kanë nevojë të bëjnë konfirmim pjesëmarrje për Provimin e Shtetit, pasi për të gjithë fituesit e VAP, emri herë e parë (dmth direkt pasi kanë fituar VAP) regjistrohet automatikisht për Provim Shteti.

KSSH: I kemi kërkuar qeverisë status të veçantë për këtë sektor, paga 300 mijë lekë

Festa e gruas, Subashi: Rreth 100 mijë gra e vajza, sklave moderne të fasonerive

"Detyrohen të kthejnë mbrapsht një pjesë të pagës"

Voltiza Duro

Rreth 100 mijë gra e vajza që punojnë në sektorin e fasonerisë, janë të skllavëruara. Ato nuk trajtohen me dinjitetin që u takon, por thjesht si makineri pune në zinxhirin e prodhimit. Ky është konkluzioni i arritur nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Anisa Subashi, zv. presidente në këtë sindikatë tregon të gjitha problematikat me të cilat ndeshen sot punonjëset e rrobaqepësive e këpucarive. Ajo shton se në shumë raste, punëdhënësit u kërkojnë të kthejnë pas një pjesë të pagës, duke shkelur kështu kodin e punës. Subashi thekson se KSSH i ka kërkuar qeverisë që të miratojë një status të veçantë për këto punonjëse, një prej pikave të së cilit është paga minimale prej 300 mijë lekësh të vjetra.

Cilat janë disa nga problematikat me të cilat ndeshen sot vajzat e gratë shqiptare?

8 marsi është një ditë proteste dhe jo feste! Problemet e grave në Shqipëri janë në dimensione shumë-planëshe. Ato fillojnë që nga mentaliteti tradicional, kultura dhe emancipimi shoqëror, pa barazë në marrëdhëniet e punës, diferenca në pagë e në pozicione drejtuese, modelet e gabuara gjinore. KSSH tashmë është bërë pjesë aktive dhe po udhëheq gjithë aksionin e fushatës sindikale të ndërmarrë, me takime promovuese dhe sensibilizuese me të gjithë aktorët social, punëdhënësit dhe qeverinë.

Vazhdimisht përpigimi që në Kontratën Kolektive të ndikojmë që gratë të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime me burrat në vendin e punës, por praktikisht kjo vazhdon të mos realizohet pasi në shumë profesione burrat ndihen më të avantazhuar.

Cilat janë sektorët më të vështirë të punës për femrat?

Rezultoni se femrat janë prezente në shumë numërisht sesa burrat në sektorë si administratë, shërbime, arsim, shëndetësi, tregti, banka, informatikë, kompani sigurimesh, fasoneri, etj. Nga të gjitha këto sektorë, ato që kanë të bëjnë me punën e krahut dhe që përdorin teknologji të ulët, janë profesione që paraqesin vështirësi dhe për rrjedhojë, shfaqin edhe rrezik për shëndetin apo për fizikun e grave, siç është industria fasonë, bujqësi,



Zv. presidente e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, Anisa Subashi

SEKTORET ME TE VESHITRE

Rezultoni se femrat janë prezente më shumë numerikisht sesa burrat në sektorë si administratë, shërbime, arsim, shëndetësi, tregti, banka, informatikë, kompani sigurimesh, fasoneri, etj. Nga të gjitha këto sektorë, ato që kanë të bëjnë me punën e krahut dhe që përdorin teknologji të ulët, janë profesione që paraqesin vështirësi dhe për rrjedhojë, shfaqin edhe rrezik për shëndetin apo për fizikun e grave, siç është industria fasonë, bujqësi, etj.

sia, etj.

Sa respektohen kontratat e punës dhe a paguhen rregullisht sigurimet e punonjëseve?

Kontratat e punës janë mjete institucionale që jo vetëm garanton besimin dhe detyrimin reciprok rreth palëve, por institucionalizojnë marrëdhënien e punës, konform ligjit në fuqi. Kontratat Individuale të punës, në saj të masave shtrënguese të qeverisë dhe detyrimeve ligjore, pothuajse nënshkruhen nga 100% e të punësuarve, por këto kontrata, në pjesën më të madhe të tyre janë formale, kopje e legjislacionit në fuqi dhe shpesh në disfavor të punonjëseve, pasi nuk kryhet njohja dhe informimi i punonjësit me të drejtat, detyrimet e tij dhe me mbështetjen ligjore që duhet të ketë kjo kontratë. Shpesh këto fir-

mosen në mënyrë të njëanshme, pa u lexuar nga punonjësi dhe atij nuk i jepet në dispozicion një kopje në bazë të ligjit, por mjaftohen vetëm me depozitim të tyre tek punëdhënësi.

Në këto kontrata shpesh nuk përcaktohet paga, orari i punës, shpërblimi, mbrojtja nga diskriminimi, pa folur pastaj për kontratat e punës me kohë të pjesshme, apo me material porositi për punët në shtëpi, tele-punë, etj., të cilat asnjëherë nuk nënshkruhen konform ligjit. Në këto kontrata asnjëherë nuk përfshihet çështja e kualifikimit periodik, apo të mësimit të profesionit, si detyrim të punëdhënësit për t'i garantuar këto shërbime falas nga ana e punëdhënësit.

Sa është numri i grave që punojnë në fasoneri

dhe a janë të deklaruara këto vende pune?

Veçanërisht në këtë 10-vjeçar, industria e fasonerisë dhe ajo e call-center kanë shërbyer si valvula për të shfrenuar problemet sociale, veçanërisht ato të papunësisë. Është e vërtetë që këto industri punësojnë një numër të konsiderueshëm punonjësis. Industria fasonë punëson punonjësit të pa-kualifikuar, ose me kualifikim të mesëm. Shifra e të punësuarve në këtë sektor shpesh janë kontradiktore pasi informalleti dhe punësimi sezonal, apo punësimi me kohë të pjesshme është vështirë për tu verifikuar. Nga shifrat zyrtare pretendohet se janë rreth 75 mijë punonjësit në sektorin e fasonerisë, por statistikat e biznesit flasin për rreth 100 mijë të punësuar në këtë industri. 95% e këtyre të punësuarve janë gra dhe pjesa më e madhe e tyre me moshë nën 40 vjeç.

Sa varion paga në këtë sektor dhe a e justifikon sadopak vështirësinë që mbart kjo punë?

Pjesa më e madhe paguhet me pagë minimale zyrtare, 26 mijë lekë. Janë të shumta rastet e evidentuara nga ne, ku disa kompani apo ndërmarrje i paguan një punonjësit 26 mijë lekë në bankë dhe pastaj i detyrojnë ato që t'i kthejnë një pjesë të shumës (5000 - 7000 lek). Ky fenomen nuk është vetëm në fasoneri, por edhe në sektorë të tjerë privat, si tregti, shërbime hoteleri-turizëm, polici pri-

KONTRATAT

Kontratat e punës janë mjete institucionale që jo vetëm garanton besimin dhe detyrimin reciprok rreth palëve, por institucionalizojnë marrëdhënien e punës, konform ligjit në fuqi. Kontratat Individuale të punës, në saj të masave shtrënguese të qeverisë dhe detyrimeve ligjore, pothuajse nënshkruhen nga 100% e të punësuarve, por këto kontrata, në pjesën më të madhe të tyre janë formale.

GRATE NE FASONERI

Veçanërisht në këtë 10-vjeçar, industria e fasonerisë dhe ajo e call-center kanë shërbyer si valvula për të shfrenuar problemet sociale, veçanërisht ato të papunësisë. Është e vërtetë që këto industri punësojnë një numër të konsiderueshëm punonjësis. Industria fasonë punëson punonjësit të pa-kualifikuar, ose me kualifikim të mesëm.

vate, etj. Paga që këto punonjëse marrin nuk e justifikon vështirësinë e profesionit, pasi ato punojnë në këmbë, nën zurma dhe dridhje, kimikate, etj.

Industria fasonë fatkeqësisht në Shqipëri vazhdon të shikohet si prioriteti punësimi dhe zhvillimi, por e vërteta është ndryshe, pasi kjo industri më shumë i skllavëron punonjëset sesa plotëson nevojat ekonomike dhe u jep atyre një punë të denjë. Këto biznese të cilat janë kryesisht të huaja, i prodhojnë produktet e tyre me kosto krahu pune të lirë dhe anashkalojnë zbatimin e ligjshmërisë së punës.

Si paraqiten kushtet e punës në fasoneri dhe si trajtohen punonjëset?

Diskriminimi i punëtorëve në këtë industri po kalon në disa dimensione të gjëra, të cilat tashmë janë bërë shqetësim, jo vetëm për sindikatat, por për të gjithë shoqërinë në tërësi. Punonjëset këtu përballen me kushte pune dhe prodhimi nën dinjitetin njerëzor, shpesh kjo e shoqëruar dhe me arraçgancën e administratorëve apo pronarëve. Ligji i punës këtu zbatohet formalisht dhe është e pamundur që strukturat ligjzbatuese të shtetit të ushtrorin me efikasitet kontrollin e tyre. Punonjëset shpesh trajtohen jo si qenie humane, por si makineri pune, në zinxhirin e prodhimit. Ato punojnë me orë të zgjatura, me norma të rritura dhe të pa stu-

diuara teknologjikisht, qëndrojnë në kushte të kufizuara dëgjimi dhe shikueshmërie, si dhe përballen me agjentë kimik të bojërave kimike. Pjesa më e madhe e këtyre ndërmarrjeve janë kaponone të ish-ndërmarrjeve socialiste, të përshtatura, të cilat pamundësojnë plotësimin e standardeve për ajrim, ndriçim, mensë, dhomë mjeku, etj.

Cilat janë disa nga zgjidhjet që sindikata juaj sugjeron për zgjidhjen e problematikave të sipërpërmendura?

Ne po i kërkojmë qeverisë shqiptare, që për gratë që punojnë në sektorin fason, shumica e të cilave vijmë nga familje me problem të theksuara ekonomike dhe sociale, të hartohet dhe miratohet një status i veçantë për to.

Ky status, ndër të tjera, duhet të përfshijë që paga minimale për këto punonjëse të jetë 30 mijë lekë; këto punonjëse në mënyrë detyruese duhet të kryejnë të gjithë vizitat periodike për sëmundje profesionale, si dhe të kryejnë mamografinë falas me shpenzimet e shtetit, apo të punëdhënësit; Bashkitë duhet t'i japin prioritet për shërbime sociale të tyre duke garantuar me ligj përfitime ekonomike dhe dhënies prioritet për sa i përket skemave të strehimit social të pushtetit vendor; për fëmijët e këtyre punonjëseve në shkollë të lartë jashtë rrethit ku jetojnë t'u jepen bursa studimi.

Publikohet në Fletoren Zyrtare lista me personat që u është njohur e drejta për kompensim

Agjencia e Trajtimit të Pronave Publikon listën e 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtimit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të dosjeve dhe pronarët që nuk janë njohur me vendimin duhet t'i drejtohen gjykatës.

KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK
Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të

Dosjet 1993-2013, lista me 611 pronarët që marrin paratë

Përfituesit në të gjithë vendin, ja si do të paguhen

cilësorë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndry-

shuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të

kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompen-

sohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuara u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

LISTA ME 611 PRONARËT QË MARRIN PARATË

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Gjirokastrë		3333	335
Korçë		120	931
Korçë		1772	1788
Vlorë	Sokrat Milo	1110	1890
Dibër			2408
Dibër	XHET AN NASUFI	300	850
Dibër			2828
Lezhë	Pashk Llesh Nokaj	1312	560
Lezhë	Gjok Mehil Pali, Ndue Mehil Pali	3000	6025
Elbasan	PASHKO MILLOSHI	5090	6710
Fier	Petref Muka		1200
Tiranë	FIQRI MANÇAKU	12426	0
Korçë	Vasfi Sino	840	120
Korçë		1120	5190
Korçë	Kimete Alushi		0
Tiranë	HAMDJE ARKAXHIU		4345
Tiranë	MUSA MAHMUDAJ		60.5
Shkodër	Hajrullah Hoxha	623	168
Korçë	Hekuran Kulla	2550	800
Tiranë	ALFRED SALLI	1616.57	2614.7
Korçë	Mirjeta Marko	300	200
Tiranë	BINOK HATIBI	665	2023
Tiranë	KADRI SPAHIA	3311.5	3388.5
Tiranë	KADRI SPAHIA	3311.5	3388.5
Durrës			5000
Durrës		450	2032
Tiranë		2535	1075
Tiranë	ALI RRELI	2850	1150
Tiranë	Abdulla Alliu	20	0
Tiranë	MERSIN LUCA	58	290
Durrës	Mereme Merlika		100
Durrës	Abdyll Deliu		882
Korçë			5314
Korçë			1972
Korçë	ATHINA QIRICI	9724	7526
Durrës			6667.1
Durrës	Gezim Taga		1550
Elbasan	ALEKSANDER BARDHA		8800
Tiranë			1702

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Elbasan	Daut Gjeta	5970	14749.9
Gjirokastrë	Kico Xhavarra	85	160
Elbasan	DAUT GIETA	5990	14747.9
Elbasan		1192	7108
Fier	Shaqir dingozi		3000
Fier	Hekuran Dingozi		3000
Lezhë	Ndue Zef Frroku		3623
Durrës		3870	3205
Durrës			1306
Korçë	Vasil Ruvina		1602
Gjirokastrë	Bujar Sinani		3480
Shkodër	Aishe Haxhija	540	1340
Durrës	Andon e Llazari Beqari		150
Tiranë	SADIK XHEMNICA	8470	415
Korçë	Ermon Frejcka, Kristaq Trabiata, Natashe Nenashe, Pandeli	4497	6907
Korçë	Hajrie Belortaja	6050	5505
Elbasan	NDRICIM PLANGARICA		0
Fier	Mitat Manko		4000
Vlorë	Elmaz Inataj		0
Fier	Vasil dhamo		3000
Korçë	Skender Shaholli	570	630
Korçë	Nazmi Shamo	940	160
Korçë		240	670
Elbasan	DHIMITER KOCAQI		0
Fier	Hasan Bregu	10000	8900
Vlorë	Nimete Ligaci	4560	440
Vlorë	Engjell Rami Mastori	2626	510
Vlorë	Halit Minxolli	1932	8121
Korçë	Mehmet Cuko	573	786
Korçë			314
Gjirokastrë	Petraçq Steri	636	300
Korçë	Vllazëria Çollaku		0
Durrës		3960	16040
Durrës			553.75
Vlorë	Llambi Kokali	949	351
Vlorë	Selman Roboci	8457	524
Fier	Bexhet Jacellari	5000	8298
Korçë			0
Korçë	Bajame Mersini	155	1324
Durrës	Partizan Vezi	1682	3918

Shkodër	Met Raboshta	43	716	Korçë	Zenel Asllani	2442	2288
Tiranë	Agim Ferra	531	1293	Vlorë			1425
Fier	Selam Cela		4040	Elbasan	NIKOLL HAXHILLAZI		155
Korçë		1215	270	Berat	Feruze Lamçe	4240	1460
Korçë		808	79	Gjirokastër	Petrit Demçe	271	260
Korçë		4548	2192	Gjirokastër	Barjam Xhunga	2999	8937
Vlorë	Rajmond Iliazi		0	Gjirokastër	Shaje Nunaj		1400
Vlorë	Spiro Milo	901.5	400				
Vlorë	Neki Goxha		842	Durrës	Ikbale Perka		0
Korçë	IVANE LLAKMANI		0	Gjirokastër	Xhelo Ibrahim+Liri Xhezo	105	23
Shkodër	Vitore Gjoni	790	0	Korçë	Vilermini Nika	5700	3300
Shkodër	Mehdi Kurtalia	7010	2610	Durrës		6450	2040
Durrës	Reshit Farruku		0	Elbasan	BENON BEDHIJA (BEDHINJA)	810	6190
Vlorë	Idriz Muço	5100	3713	Tiranë	IDRIZ DERVISHI		634
Vlorë	Ibrahim Çafuli	200	1640	Korçë	Vëllazeria Radomi	3181	4059
Lezhë	Ndue Preng Kacorri		0	Vlorë	Nexhmi Ballka	1507	4755
				Vlorë	Nexhi Hado	2267	1233
Durrës		6400	4425	Shkodër	Isa Kapllan Dobreja		0
Durrës			3228	Shkodër	Daut Hasi		0
Fier	Tahir Xheka	2915	7195	Durrës		5000	5000
Tiranë	EMINE TURKA, MUSTAFA, (GJINI SULEN)		1703	Durrës			35
Gjirokastër	Nastas Mingo	360	840	Durrës		223	0
Fier	Mystehak Zeneli		500	Kukës	Mehmet Uke Mustafa	4373	5499
Shkodër	Fitnete Dizdari (Bala)	1010	248	Dibër	Hysen Kaleci		0
Korçë	Avni Muslli		0	Korçë		1021	1137
Shkodër	Cezar Mjeda	3332	4246	Korçë		806	594
Shkodër	Trashegimtare Belaj	270	390	Vlorë	Amali Petro	2655	652
Tiranë	MYSLYM KURDARI	439.1	880.9	Vlorë	Stavri Nasi		10748
Durrës		388	35	Tiranë	BEDRIE SKENDERI (SULO)	3900	100
Durrës	Gani Dema	1210	440	Dibër	VEBI ÇUPA		30
Durrës	Xhemal Dollma	4376	300	Tiranë	SULEJMAN KAZAZI	5000	1175
Durrës	Fatmir Hoxha		0	Tiranë	MOTRAT E KISHES KATOLIKE MOTRAT E KISHES KATOLIKE	388	1133
Korçë	Ismete Kolami	105	171	Elbasan	SELIM CEPA		460
Tiranë	ARBEN TABAKU	5000	15000	Elbasan	BUKURIE DEMIRI	520	6120
Vlorë	Thoma Pikuli		0	Gjirokastër	Mustafa Karafili	6014	4706
Gjirokastër	Turan Kopeci		2620	Tiranë	AHMET KAZIU	13715	2841
Gjirokastër	Xhelo Ibrahim+Liri Xhezo	340	38	Tiranë			4000
Korçë			1555	Tiranë	MUHARREM TAVARINI	1950	10550
Korçë	ZINI TERROLI	2660	4919	Tiranë	Hysen Loçka		9272
Korçë	ZINI TERROLI	2660	4919	Tiranë	LIRI KERMENDI	3868	132
Korçë	Jahja Xhuti	1787	813	Korçë		4149	5370
Korçë		1143	986	Korçë			1800
Lezhë	Mark Dod Mikeli		6239.6	Lezhë	Kol Gjok Kacorri		0
Vlorë	Pajtim Kapaj		0	Gjirokastër	Skënder Qafa		2151
Vlorë	Guri Kamberi	5000	5612	Korçë			71.5
Vlorë	Aristidh Goro	776	40	Elbasan	EMINE LILA		432
Tiranë		4280	2470	Tiranë	BISHA, HYSNI HYKA	3000	6325
Tiranë	RAMAZAN DEMIRI		21612	Tiranë	AHMET SHEHI	58	11
Elbasan	SHABAN GRIPSHI	1804	0	Tiranë		1475	3662
Fier	Trifon Marku	5000	5360	Fier	Rapi Shaban Goxhaj	2600	3530
Durrës		5000	16	Vlorë	Velo Dervishi		2500
Durrës		5000	22837	Gjirokastër	Perparim Hasko		425
Durrës			1253	Elbasan	SHPETIM BULÇARI	127	588
Durrës	Alush Meça	5000	11000	Vlorë	Kadri Maska	248	272
Vlorë	Xhelal Abazi	4613	2887	Lezhë	Vath Hasan Tafa		4050
Vlorë	Sotir Fili	2450	300	Lezhë	Shyqyri Dervishi		10180
Korçë	Figjiri Vënxa	3981	2739	Elbasan	YMER KOLA	21151	7849
Korçë	Figjiri Vënxa	3981	2739	Elbasan	SEIT DOSKU	17190	12535
Korçë		165	321	Elbasan		4696.8	5903.2
Korçë			256	Vlorë	Koco Jorgji	1766	400
Tiranë	FEJZI VISHKO	133	60	Fier		4270	7355
Tiranë	TRASHEGIMTARET	7004	8373	Dibër	REMZI KALECI		0
Tiranë	TRASHEGIMTARET	14427	18579	Durrës	Gjyle Lajthia (Noka)	2580	420
Tiranë	TRASHEGIMTARET	18989.5	29768.5	Shkodër	Angjelin Shiroka		676
Tiranë	AHMET TURKU	333	70	Elbasan	XHAFERR ÇEKA	302	223
Gjirokastër	Spiro Curri		1200	Fier	Shahin Sulaj	5000	6062
Durrës		2330	8315.75	Tiranë	QERIM SHIMA	13200	125
Durrës	Nikolla Ziu		1995				

(vijon)

Ministria e Financave publikon listën me dosjet që ka shqyrtuar nga janari deri në tetor 2018

Ish-të përndjekurit, 5 mijë trashëgimtarët që marrin paratë

Dokumentet që duhet të plotësojë çdo përfitues

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë dokumentet në Ministrinë e Financave. Janë në total 5 mijë përfitues, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e Paguesave nga janari deri në tetor të vitit të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e përfituesve me të gjitha detajet për çdo dosje. Në listën e publikuar shënohet me "V" në rastet kur dokumenti është në rregull, me X kur është gabim dhe është kolona bosh kur dokumenti nuk është paraqitur.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimit apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës

nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative e lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave.

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIMI	NUMER PERSONAL LLOGARIA BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILJAR	DESHMI I TRASHIGMIE	PROKURE	CERTIFIKATE PER CDO NDRYSHIM IDENTITI
KUTTIM MYZEJEN XHEVAT	HOXHA			V					P	
	HOXHA			V		X	X	V	P	
	ILIRJAN FLUTURA	HOXHA		V					P	
ESMA PETRIT	SULA			V	V				V	
	HOXHA					X	X	V		
	SKENDER BUKURRIJE BARDHYL DASHURIE	HOXHA		V					P	
	MOLLA	HOXHA		V					P	
	HOXHA	SINANI		V					P	
	TRENDELINA	ALLKO		V					P	
	PELVAN VALENTINA	HOXHA		V					P	
	IBRUSH			V					P	
RIZA	KAMBERAJ					V	V	V		
	REFIT REFIE	KAMBERAJ SELAMAJ		V	V				V	
	VIOLETA	ALIU		V					P	
RAMIZ	KAMBERAJ					V				
	HAMDI COBAN RRUFE	KAMBERAJ MALAJ				V				
DRITA PASHAKO ISLAM FLORESHA	BESHOLLI			V	V					
	BESHOLLI			V	V					
	ALLARUPI RAKIPI			V	V					
	NEVREZE SHKELQIM SARAFIN ADRIATIK ARBEN ALMA	DAJKO RAKIPI RAKIPI RAKIPI RAKIPI KASAPI		V	V	V	V	XFK		

DILE	LEKA (LULI)					X	X	X		
NDOC	LEKA			V	V				V	
DAKE	RRUSHINI					V	V	V		
	NORA	RRUSHINI		X	X					
	LINE	RRUSHINI		X	X					
	GEZIM	RRUSHINI		X	X					
	NIKOLIN	RRUSHINI		X	X					
	ARIAN	RRUSHINI		X	X					
	PIERIN	RRUSHINI		X	X					
	KOZETA	RRUSHINI		X	X					
DEDE	RRUSHINI					V	V	V		
	NDUE	RRUSHINI		V					P	
	PRENDE	NDOJA		V					P	
	BORE	STAKA		V					P	
	MARTE	CARDAKU		V					P	
	KOLE	RRUSHINI		V					P	
TOME	RRUSHINI			V	V				V	
PRELE	RRUSHINI			V					P	
LIN	RRUSHINI			V					P	
GJOK	RRUSHINI			V					P	
ISMET PARSJIE	BRAKOLLARI					V	V	V		
GURALI	BEJKO			V	V					
	BRAKOLLARI					V	V	V		
	ALBERT ROMEO	BRACHOLLARI		V					P	
	ZHILJETA	LULI		V					P	
	EDLIRA	PECA		V					P	
DALLANDYSH E	DERVISHI			V	V					
AMET	BRAKOLLARI					X	X	X		
	NELSON	BRAKOLLARI		X	X					
	SONILA	HYSENLLARI		X	X					
	PELLUMP	BRAKOLLARI		X	X					
	MARSEL	BRAKOLLARI		X	X					

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIMI	NUMER PERSONAL LLOGARIA BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILJAR	DESHMI I TRASHIGMIE	PROKURE	CERTIFIKATE PER CDO NDRYSHIM IDENTITI
		ARDIT	BRAKOLLARI	X	X					
		erëve	brakollari	V	V					V
Mehizë Pelivan Nako Selman	Sela Sela Kasem Sela					V	V	V	V	
		Gramos Sami Klodjama	Sela Sela Sinemema	V	V					P
						V	V	V	V	P
Nexhip	Leskaj					V	V	V	ZV	
		Lavdosh Dufina Bego Fatbardha	Leskaj Zota Leskaj Budo	V	V	V	V			
						V	V	V		
ILIA	TOCI					V	V	V		
		SOTIR FLONIA	TOCI HYSAJ	X	X					
VANGJEL	TOCI					V	V	V	V	
		DORINA PLARENT	TOCI TOCI	V	V	V	V			
KASEM	VORA					V	certifikate negative	V	V	V
		ARBEN ISMET GENTIANA AVNI BAJRAM ANILA	VORA VORA GORANA VORA VORA VOGLI	V	V	V	V			
SKENDER ZYLIIHA	VORA JASHARI					V	V			
BAJRAM	VORA								V	V
SHEFIKAT	IMAMI					V	V	V		
		NAIM ILIRJANA BURBUQE CAJUP TEUTA	IMAMI SKENDO KADIU IMAMI SEIDIAJ	V						P1
						V				P1
						V	V			V1
						V				P1
AGIM FITIM HIQMET	XHINDI XHINDI XHINDI					V	V			
						V	X			
ISUF	XHINDI					V	V			V
		PELLUMB ALMA MIMOZA	XHINDI SENKA HALILI	V	V					P
ZENGIJNE	ZAIMI					V	V	V		P
		ZJIA ERVEHE	ZAIMI MOLOSIU	V	V					
BUKURRIJE	KARALLIU					V	V			
		MYRTEZA FREDERIK FATOS	KARALLIU KARALLIU KARALLIU	V	V	V	V			
Beshire Resnjije Marikë Leonard Lulë	Memmaj Arapaj (Memmaj) Xhiferaj (Memmaj) Memmaj Memmaj					V	V			P
						V				V
						V				P
						V		V	V	X
Lulë Mrika	Gruda Keraj					V	X	X	V	
		GJYSTE	VIKSANI							hdore
		LIZE	GJELAJ							hdore
		NDUE	KERAJ	V	V					hdore
		TEREZE	KOLDODAJ							hdore
		KATRINE	LUKA							hdore
		VERONIKA	LULAJ							hdore
		FRAN	KERAJ							hdore

Pashka	Gjekmarkaj	Florinda Tonin Vera	Shjefni Gjekmarkaj Dodaj	V V V	V V V	V V V	V V V	V P P
TRASHE	MARKAJ			V	x	V	V	V
NAQE	LEKAJ			V		V	V	V
NDOC	MARKAJ			V		V		
MARIE	LEKAJ			V	V			
PRENDE	CUNI			V	V			
MITHAT	VRIONI			V	V	V	V	V
		ARBEN ARION	VRIONI VRIONI	V V	V V			
HEKUR	VRIONI			V		V	V	V
		BLEDAR ETLEVA ENKLEJDA	VRIONI KONCI VRIONI	V V V	V V X			
DONIKA AGIM	OMARI VRIONI			V V				
		BONIN JORIDA	VRIONI VRIONI	V V	V V			P
		ELJNAR	OMARI(VOSHITNA)	V	V			V
						V	V	V
caje Sabri	shani Shani					V	V	V
		Makbule Fluturije Drita Shkelqim	Tago (Shani) Yhita (Shani) Muzhaqi (Shani) Shani	V V V V	V V V V			
Kadri	Shani					V	V	V
		Astrit Luani Edmond Ramadan Shkelzen Gent	Shani Shani Shani Shani Shani Shani	X X X X X X	x X X x x X			
						V	V	V
ENDRIETA	RADOVICKA					V	X	X
ENRIK GENCI	GJOKA GJOKA			V V	V V			
TEFIK DAVIE	MURRJA ABDURAMANI					V	V	X
MIRVET	MURJA					V	V	V
		MURJA MURJA MURJA MURJA FERUKU		V V V V V	V V V V V			
				V	V	V		
HAXHIRE	VARDHAMI			V		V	V	V
DILE MARK	PRENGA PRENGA					V	V	V
		PRENGA PRENGA PRENGA PALUCA		V V V V	V V V V			
PASHKE ZEF	PRENGA PRENGA			V V	V V			
GION	PRENGA			V	V	V	V	V
		GJEKA PRENGA ANASTASI		V V V	V V V			
PRENG	PRENGA			V	V			
						V	V	V
TUSHE KALOSH	KOLA KOLA					V	V	V
						V	V	V
BILAL	KOLA			V		V	zevendesim	V
		KOLA KOLA KOLA HAXHIU		V V V V	V V V V			
ADEM	KOLA			V			zevendesim	P
HALIT	KOLA			V		V	zevendesim	
		KOCULLI XHAFERRI		V	V			
SELMAN	DERVISHI			V	V	V	V	
		DERVISHI FERATI DERVISHI SHEHU		V V V V				P1 P1 P1
BAFTIJE	MARKU					V	V	V
LAZAM NAZIFE	DERVISHI					V	V	V
		DERVISHI DERVISHI		V V	V V			VV1V2
NAZIFE MIDE	MADRI DERVISHI					V	V	V
MERJEME EMRIE	KABA KACANI			V V	V V			P3 P3
MUEDIN	DERVISHI			V	V	V	V	V3
NURIJE HYLLDEZE	GJYZELI HOXHA			V V				P P
		GJYZELI		V	V	V	V	V
HADILE DALLENDYSHE	MUSTAFARAJ GRABOVA			V V	V V	V	V	V
TEFTA	SHARRA			V	V			
BILAL	GRABOVA			V	V			
SALO FATIME	MIRACI CEPE					V	V	V
		CEPE		V	V	V	V	V
HANUSHE	LALA			V	V	V	V	V

		LALA AHMETAJ		V V	V V			
		SHANI HUSI		V V	V V			P
		LALA NIKA		V V	V V			P
MAZIE	NANI			V V	V V	V	V	V
HABIL NEXHMIE	BELLO ONJEA			V V	V V			
VERIE	MULLAJ			V	V			
KOZETA ELI	MUXHAJ KARAGJOZI			V V	V V			
Nadire Kadri	Buzhaji Sata			V V	V V	XLGjev	V	V
		Luljeta Muhamet Eduart Suzana Valentina Gazmir Florina	Hyseni Sata Sata Kocqi Sata Sata Sata	V X X X X X V	V X X X X X V			
Sali Hakik	Sata Sata			V V	V V	V		ZV
		Ismael Nazmie Nuric Zejana Gezim	Sata Biblli Laci Haxhij Sata	V V V V V	V V V V V			V P P P
Mine Hafike Kasem Cape Hamit	Kurti Bozhicka Shelji Doqi Shehu			X X X X X	X X X X X			ZV
		Valentina Nurbaje Fatmir Bardhyl Agron Petri Genci Tani	Mena Noka Shehu Shehu Shehu Shehu Shehu	X X X X X X X	X X X X X X X			
Tushe	Xhetari					V	V	V
		Myfiar Luljeta Muhamet Esat Servete	Xhetari Preni Xhetari Xhetari Tara	X X X X X	X X X X X			ZV
		Lulfar Dave Luljeta Kastrit Rruzhdije	Hysa Sommer Hysa Hysa Hysa	V V V X V	V V V X V			P P P P
						V neg	V	V
Hariz	Veledi					V	V	ZV
		Bushe Violeta Izeir Bajram Marushaqe Ervehe Aslan	Veledi Shyti Veledi Veledi Kamberi Malaj Veledi	V V V V V V V	V V V V V V V			V P
						V	V	V
Nexhip	Taklli					V	V	ZV
		Bukurije Nafije Adil Xhuma	Mane Dervisha Taklli Taklli	V V V V	V V V V			
Qesere Nanine Nexhanije	Kalaja Reci Bogdani			V V V	X V V			X1
		Majlinda Kozeta Shqipe Merita	Bogdani Bogdani Katroshi Fortuzi	V V V V	V V V X	V	V	V
Mereme Sabrije Hamide Gezim	Hoxha Mara Faja Vurpsi			V V V V	V V V V			
		Erin Asla	Fortuzi Sheqeri					X X1
Petrit Muhazeze (Qbare)	Delu Vejtani			V V	V V			V
Jorgo Coco (Kostandino)	Thamo Thamo			X V	X V	V	V	V
		Krsavji Niqiflora Areti	Babi Ciko Alekxi	V V V	V V V			X
						V	V	V
Veziqe	Resulaj					V	V	V
		Agim Ildris Zyrako	Resulaj Resulaj Keqaj	V V V	V V V			
Xheko Shero Mibete Jonas	Hamataj Cela Pashaj Hamata			X V V V	X V V V	V	X	X
Rakbe Kadrie Harashe Vendim Kujtim	Braho Ahmetaj Braho Harashe Braho					V V V V	XLGjev	V V

Bukuritë e rralla të Parkut Kombëtar Karaburun-Sazan dhe kërcënimi nga ndotja

Rreth 205 kg ishte pesha e mbetjeve të mbledhura vetëm në një ditë në Shen Jan, në afërsi të Parkut Kombëtar Detar në Karaburun Sazan. Një aksion pastrimi i organizuar në kuadër të iniciativës globale "Dita Ndërkombëtare e Pastrimit të Plazhit", nxori në pah shifrat alarmante të ndotjes së detit në një prej zonave bregdetare që supozohet të jetë ndër më të pastrat në vijën tonë bregdetare.

Parku i mbrojtur Karaburun-Sazan është një ndër pasuritë më të mëdha të Shqipërisë. Ka bukuri të mahnitshme në këtë park, por që çdo ditë janë nën kërcënimin e shkatërrimit të tyre.

Për këtë arsye, një projekt i dedikuar për mbrojtjen e Parkut detar funksionon prej disa vitesh në Vlorë. Në Radhimë është ngritur një qendër vizitorësh atje ku bashkohen të gjithë aktorët e përfshirë në projektin "Përmirësimi i mbulimit dhe efektivitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura detare e bregdetare" që janë angazhuar për ruajtjen e ekosistemeve të parkut Kombëtar Detar. Një grup i përkushtuar i projektit të UNDP, punojnë çdo ditë me shumë pasion në përpjekje për të ruajtur të paprekur Parkun Kombëtar Detar.

Pranë qendrës së informacionit gjendet edhe ajo e riaftësimi dhe shpëtimit të breshkave detare. Përgjatë vitit që shkoi, shtatë breshka Caretta caretta i janë nënshtruar rehabilitimit në qendër. Ka një ekip të dedikuar për shpëtimin e breshkave ku përfshihen edhe bi-



ologë e veteriner që mundësojnë mjekimin e këtyre breshkave të rralla dhe kthimin e tyre në det.

Ka specie të rralla në Parkun Kombëtar Detar për të cilat ekipi i kësaj qendre është angazhuar t'i mbrojë duke u përpjekur dita ditës të afrojë në këtë projekt aktorë të ndryshëm nga organizatat ndërkombëtare, por edhe pushteti vendor. Në këtë park gjenden livadhet e Posidonias, Brigjet Koralgjene, llojet e ndryshme peshqish, breshka e detit, atje gjendet edhe një specie si Foka Murgeshë shumë e rrallë për brigjet mesdhetare. Në këtë park gjenden 36 specie detare. Këto specie janë sot të rrezikuara dhe janë të përfshira në konventa ndërkombëtare

te mbrojtjes;

Për ruajtjen e tyre është angazhuar projekti i UNDP me mbështetjen e qeverisë italiane nëpërmjet Agjencisë Italiane për bashkëpunim dhe zhvillim duke realizuar një aktivitet të dedikuar për mbrojtjen e Parkut Detar. Komponentët kryesorë të punës së projektit janë forcimi i modelit të praktikës menaxhuese për zmdb-të në Shqipëri (Zonat e Mbrojtura Detare), forcimi i kapacitetit institucional bazuar në qeverisje dhe mbështetje për rrjetin e zmdb-ve dhe ndihmese për krijimin e një rrjeti të zmdb-ve duke u bazuar në modelin e zonave të mbrojtura Karaburun-Sazan.

NDOTJA DHE MBETJET NË DET

Nga studimi i ndotjes në plazhet në anën lindore të Gadishullit të Karaburunit, rezultoi se sasia e njësive ndotëse detare të gjetura në çdo vend varion nga 687 njësi ndotëse në plazhin e Shën Vasilit, në 5440 njëso ndotëse në zonën e Dhimëkushtës (me një maksimum prej 10095 njësi ndotëse në plazhin Dhimëkushtës. Sipas studimit të UNDP-së, dendësia mesatare e mbetjeve në plazh varion nga 0.99 njësi/m² në plazhin e Shën Vasilit, në 64.6 njësi/m² në zonën e Dhimëkushtës. Kjo është pothuajse 100 herë më e lartë se mesatarja e plazheve në detet Adriatik dhe Jon (0.67 njësi/m²).

NDOTJA

Nga studimi i ndotjes në plazhet në anën lindore të Gadishullit të Karaburunit, rezultoi se sasia e njësive ndotëse detare të gjetura në çdo vend varion nga 687 njësi ndotëse në plazhin e Shën Vasilit, në 5440 njëso ndotëse në zonën e Dhimëkushtës (me një maksimum prej 10095 njësi ndotëse në plazhin Dhimëkushtës. Sipas studimit të UNDP-së, dendësia mesatare e mbetjeve në plazh varion nga 0.99 njësi/m² në plazhin e Shën Vasilit, në 64.6 njësi/m² në zonën e Dhimëkushtës.

KOMPANIA E RICIKLIMIT

Që nga qershori 2018, rreth 24 operatorë ekonomikë (kryesisht hotele & restorante) aplikojnë grumbullimin e vajt të përdorur të gatimit në depozita të veçanta, sipas një grafiku të miratuar; ata asistohen nga kompania e specializuar e riciklimit e cila gjithashtu shpjegon dhe informon mbi iniciativën e riciklimit.

Studimet teknike mbi ndotjen detare u shoqëruan me aktivitetin e pastrimit të plazheve, i planifikuar në kuadër të iniciativës globale "Dita Ndërkombëtare e Pastrimit të Plazhit". Pësha totale e mbetjeve të mbledhura arriti në 205 kg vetëm në plazhin e Shen Janit!!!

RICIKLIMI

Që nga qershori 2018, rreth 24 operatorë ekonomikë (kryesisht hotele & restorante) aplikojnë grumbullimin e vajt të përdorur të gatimit në depozita të veçanta, sipas një grafiku të miratuar; ata asistohen nga kompania e specializuar e riciklimit e cila gjithashtu shpjegon dhe informon mbi iniciativën e riciklimit. Në total janë mbi

1800 kg vaj i mbledhur dhe i dërguar në kompanitë e specializuara të riciklimit.

Një nga angazhimet serioze të projektit është edhe forcimi i mbështetjes institucionale e posaçërisht i strukturave dhe autoriteteve të ngarkuar me menaxhimin dhe administrimin e rrjetit të zonave të mbrojtura detare. Në këtë aspekt punohet vazhdimisht për forcimin e kapaciteteve, njohurive dhe çka është me e rëndësishmja, për koordinimin dhe ndërveprimin e autoriteteve dhe specialisteve përkatës, administratat dhe grupet e interesit, pajisjen e tyre me njohuritë dhe instrumentet e duhur, për të mbështetur menaxhimin dhe monitorimin e rrjetit të Zonave të Mbrojtura.



Ministri serb akuza BE: Si intereson marrëveshja me Kosovën

Nënkretari amerikan David Hale: Zgjidhje për Kosovë-Serbi? SHBA s'ofron recetë



DAVID HALE

"Ka një shans që një zgjidhje gjithëpërfshirëse do të arrihet këtë vit, por vetëm nëse dialogu fillimisht do të rifillojë. Është koha për të ndaluar provokimet nga të dyja anët, për të hequr taksën dhe për ta kthyer Beogradin dhe Prishtinën në dialogun e udhëhequr nga Bashkimi Evropian dhe se të dyja palët janë të angazhuara për paqe", -ka thënë Hale.

ishit për keqardhje të humbasim këtë mundësi unike për paqe, siguri dhe rritje ekonomike", shton Hale. Presidentin Trump. Sipas tij, Amerika nuk do të ofrojë një recetë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. "Ne besojmë se ajo duhet të jetë e zbatueshme si në Kosovë ashtu edhe në Ser-

bi dhe duhet të kontribuojë në stabilitetin afatgjatë të rajonit. Vetëm Beogradi dhe Prishtina mund ta bëjnë këtë përmes negociatave të drejtëpërdrejta që nevojiten për të arritur një zgjidhje". "Udhëheqësit dhe ekipet e tyre duhet të përtërijnë negociatat e udhëhequra nga Bashkimi Evropian për të shqyrtuar të gjitha mundësitë dhe atë të qytetarëve të saj sinqerisht dhe haptazi të komu-

nikojnë. Në këtë proces, udhëheqësit e Serbisë dhe Kosovës kanë mbështetur tonë të plotë", shtoi Hale. Ai ka qenë më herët, ambasador i SHBA-ve në Pakistan, Liban dhe Jordani. Si diplomat i karrierës, në atë kohë, ai ishte i dërguar i posaçëm për procesin e paqes në Lindjen e Mesme. Ndërkaq ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Ivica Dačić, ka akuzuar shtetet e

Bashkimit Evropian se po luajnë lojë të dyfishtë dhe se nuk janë të interesuara për ta zgjidhur çështjen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Këto deklarata ai i ka bërë në prag të vizitës së diplomatit amerikan, David Hale, duke vlerësuar lart angazhimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, shkruan Tanjug. Ai ka thënë se Shtetet e Bashkuara mund të kontribuojnë në vazhdimin e procesit të bisedimeve, por vetëm nëse ndihmojnë në heqjen e vendimit për taksën të vendosur nga qeveria e Ramush Haradinajt në nëntorin e vitit të kaluar. David Hale do të zhvillojë vizita në Beograd dhe Prishtinë në datat 8 dhe 9 mars. Në një intervistë të dhënë dje për "Danas", Hale ka thënë se Kosova duhet të heqë vendimin për taksën në mënyrë që të vazhdojë dialogun i Brukselit, pasi, sipas tij, tashmë është koha që përfundimisht të arrihet një marrëveshje finale Kosovë-Serbi.

Probleme me shkrimin, Hani: Nuk kemi adresuar person konkret

Maqedoni, bastardohehet shqipja në mbishkrimet e institucioneve

Tabelat e mbushura me gabime drejtshkrimore



timin e ligjit për përdorimin e gjuhëve. Sipas tij, tabelat në pikat kufitare nuk janë në kuadër të furnizimit publik dhe shton se institucionet që nuk zbatojmë në mënyrë të drejtë ligjin për përdorimin e gjuhëve do të sanksionohen. Ndërsa në të ardhmen do të tregohet më shumë kujdes. Megjithatë, zv.drejtori i doganave, Irfan Buçi, thotë se Drejtoria e Doganave përkthimin e kanë marrë të gatshëm nga Qeveria. Ndërsa për korrigjimin e saj do të paguaj kjo drejtori. Përkthimet realisht për momentin i bën qeveria dhe na i sjellin neve si urdhëresa dhe procedohet deri tek sh-typtshkronja që merret me këtë. Mirëpo dje është bërë

ky gabim meqë ndihmës drejtori që është në doganë është maqedonas, por nuk e ka bërë me një qëllim, që të ketë gabim. Mirëpo e ka bërë, sepse nuk e ka njohur mirë gjuhën shqipe", tha Irfan Buçi- zv. drejtor i doganave. Sipas tij, gabimet në tabelën në pikën kufitare në Tabanoc, do të korrigjohen brenda ditës, ndërsa shton se gabimet e tilla janë alarm që të njëjtat të mos përsëriten në të ardhmen. Rasti me tabelën e vendosur në Tabanoc, nuk është i pari. Alsat disa herë ka alarmuar edhe për raste të tjera në të cilat emërimin i institucioneve në gjuhën shqipe është bërë me gabime të shumta drejtshkrimore dhe sintak-



sore. Agjencia e cila ka për detyrim që të sigurohet se institucionet do të bëjnë zbatimin e drejtë të ligjit për përdorimin e gjuhëve, mo-

mentalisht ka vetëm drejtorin. Ndërsa për themelimin e Inspektoratit, Ministria e Drejtësisë duhet të dalë me propozim-ligj të posaçëm.

SHKURT
Greqi, një anije me migrantë fundoset në Samos

Të paktën tre persona, përfshirë dy fëmijë, vdiqën dje pasi një anije me emigrantë në fundos në afërsi të ishullit grek Samos, njoftuan rojat bregdetare. Të paktën 12 persona u gjetën në bordin e kësaj anijeje. Dy fëmijë vdiqën, pak pasi u nxorën nga uji, ndërkohë që trupi i një burri u gjet pak më pas. "Mbi 200 kandidatë për azil kanë vdekur që nga fillimi i vitit në detin Mesdhe, pjesa më e madhe e tyre në përpjekje për të arritur në Itali", sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migrantët (OIM). Në vitin 2018, rreth 48 000 refugjatë ose emigrantë hynë në Greqi, përfshirë gati 32 000 nëpërmjet ishujve të detit Egje në afërsi të brigjeve turke.

Britani, e mitura sulmohet nga 15 persona

Një 14- vjeçar është sulmuar nga një grup i madh adoleshentësh. E mitura është plagosur në qafë dhe në dorë. Ngjarja e rëndë ka ndodhur pasditen e së mërkurës në qytetin, Coventry, Britani. Një dëshmitar në vendngjarje, i cili është banor i zonës ka thënë se ajo është sulmuar nga 15 persona. "Ajo mori lëndime në qafë dhe në dorë. Qafa e saj po rridhte gjak". E mitura u dërgua menjëherë në spital dhe iu nënshtrua operacionit, pasi plagat në qafë ishte e thellë, por nuk ka rrezik për jetën, shkruan Metro. Një vajzë 16- vjeçare u arrestua lidhur me ngjarjen. Policia ka bërë të ditur se kanë qenë shërbimet e ambulancës ato që e kanë njoftuar për ngjarjen.

Angli, sekuestrohet një furgon i mbushur me para

Policia angleze ka sekuestruar një furgon të mbushur me para gjatë një kontrolli rutinë. Brenda mjetit u gjetën pothuajse gjysmë milion Paund. Furgoni u ndalua në Leicester për kontroll dhe efektivet u habitën kur brenda zbuluan 465 mijë Paund. Shoferi u arrestua dhe do të merret në pyetje për të dhënë shpjegime për sasinë e madhe të parave për të zbuluar origjinin dhe burimin e tyre. Paratë e sekuestruara ishin në kartmonedha 20 paund dhe 50 paund të ndara në tufa. "Shoferi është arrestuar dhe do të qëndrojë në paraburgim. Ai do të merret në pyetje nga oficerët pasi arrestimi lidhet me një hetim në vazhdim të policisë", -tha një zëdhënëse policie.

Pas miratimit të marrëveshjes së Prespës ka nisur zbatimin i gjuhës shqipe nga disa institucione të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Por zbatimin ka qenë me gabime gjuhësore që ka nxitur reagime të shumta në opinion. Sipas njohësve të çështjeve të gjuhës, të gjitha përkthimet që i bëjnë institucionet duhet t'i nënshtrohen një kontrolli të detajuar, apo të presin nisjen me punë të dy agjencive që do të kenë për detyrë zbatimin e dygjuhësisë. Gabimet që janë regjistruar kryesisht kanë të bëjnë me emrin e ri të shtetit, me mospërdorimin e drejtë të disa shkronjave, përdorimin e fjalëve të huaja, apo përkthimin e fjalive pa respektimin e normave gramatikore. Gabimet e vazhdueshme drejtshkrimore në tabelat e institucioneve në Maqedoninë e Veriut kanë nxjerrë në pah koordinimin e dobët mes qeverisë, grupit për zbatimin e ligjit të gjuhëve dhe institucioneve. Si rezultat gjuha shqipe nuk zbatohet në mënyrë të saktë. Nuk dihet kush përkthen apo kush i kontrollon momentalisht këto përkthime, korrigjimi i të cilave ka kosto shtesë. Rasti i fundit ishte me tabelën e vendosur në pikën kufitare Tabanoc, ku në një fjalë të vetme ka disa gabime drejtshkrimore. I pyetur se mbi kë të bie përgjegjësia për gabime të tilla, Tahir Hani, anëtar i grupit për zbatimin e ligjit, thotë se nuk është i informuar se kush e ka bërë përkthimin e kësaj table. Unë sa kam informacion me kompetentët këtu në qeveri për përkthimin nuk kemi adresuar person konkret, i cili të themi se merr përgjegjësinë se ka bërë përkthimin e këtij mbishkrimi në pikën kufitare. Unë personalisht nuk kam qenë në dijeni- deklaroi Tahir Hani- anëtar i grupit për zba-

Flet juristja shqiptare e shkollës franceze të drejtësisë

Alba Bajraktari:

Në sistemin aktual reformat më duken si skena teatrale

"Pas studimeve nuk e përjashtoj kthimin në Shqipëri"

Egla Xhemali

Franca është e bazuar në një sistem arsimor ku e drejta i jepet gjithkujt, e ku filtri bëhet çdo vit. Kjo e bën të vështirë, sepse asnjëherë s'mund të jesh i qetë, por e bën edhe të vërtetë në vlerësim. Është shumë e bukur të dish se e ke merituar.

Është vetëm 22 vjeç, dhe ka zgjedhur prej disa vitesh të superojë pengesat nivelin studentor në Francë në një degë shumë sensibil, atë të ligjit dhe të së drejtës. Alba Bajraktari, pasi një viti punë në një zyrë avokatie në Francë vendosi t'i hyjë rrugës së studimeve për drejtësi aty në Paris, në një nga Universitetet me rankingun më të lartë vlerësues. Edhe pak dhe do të jetë në finish, por që gjithsesi kjo nuk e pengon në atë kohë që ka të ndjekë dhe degojë se çfarë ndodh në Shqipëri. Natyrisht luftë nuk ka, por ikja dhe humbja e besimit të njerëzve e pezmaton. A do të vijë në Shqipëri të japë drejtësi, edhe me reformimin e sistemit të drejtësisë? Një pyetje që është pak herët për të, por për momentin e priron ta hedhë si hap. Dhe jo vetëm atë.

Alba, pse zgjedhët të studionit jashtë?

Arsyeja ishte mundësia për një formim të plotë, si akademik, edhe kulturor. Qëllimi kryesor ishte dhe është sigurisht universiteti, përgatitja në fushën e zgjedhur dhe disiplina e punës që vetë sistemi akademik e imponojnë të studentët. Por, sot pas katër vitesh në Francë, mendoj se përfitim më i madh i të studiuarit jashtë është përballja me një strukturë të re shoqërore. Vetë përpjekja për të kuptuar mënyrën sesi kjo e fundit funksionon, është e ndërtaur, e më pas arsyet kulturore e historike që janë në origjinin e ndërtimit të saj janë elementi kryesor i formimit në këtë rrugëtim. Efekti që kjo "analizë e shoqërisë së re" ka mbi perceptimin për tonën, rrjedhimisht fillon të gjykos më pak vetë trajtat e kulturës tënde dhe t'i vlerësosh si rrjedhë e historisë që mbartin.



Pse zgjedhët drejtësinë, një fjalë e cila po lakohet rëndom së fundmi në Shqipëri?

Është një pyetje që shpesh, ndeshur me vështirësitë e fushës ia drejtoj vetes. Kjo fushë më tërhoqi sepse të jep disa "municione" për të kuptuar një realitet rregullator që mundëson pikërisht funksionimin e shoqërisë. Po, është e

vagullt si përgjigje, por siç janë edhe arsyet e një fëmije. Na kërkohet të vendosim një nga gurët themelore të jetës që po ndërtojmë, pa kuptuar ende këtë të fundit. Pse po e vazhdojmë këtë zgjedhje? Këtë e zbulova, vetëm kur fillova të punoj në një zyrë avokatie këtu në Paris. Shumë studentë, edhe këtu në Francë

zgjedhin drejtësinë sepse është një trampolinë efiçake për më vonë, dhe ofron një formim që e zgjeron spektrin e mundësive në terrenin e punës. Gjithsesi, ndryshimi midis Shqipërisë e këtyre vendeve, mendoj se është vetë sistemi arsimor, i cili nuk mundëson një filtër gjatë viteve të studimit. Thujtje të gjithë ata që nisnin këto studime në vendin tonë i përfundojnë, kjo s'është aspak normale në raport me vendet e tjera.

Çfarë ndodh me gjeneratën tuaj Alba? Sepse jashtë studiojnë edhe shumë të tjerë. Por duke u ndalur te ju, aspiratat janë për të qëndruar aty, apo për të dhënë drejtësi diku tjetër apo edhe në Shqipëri?

Prindërit që kanë sakrifikuar aq janë të gatshëm të mos kthehemi më e të ndërtojmë jetën tonë jashtë. Preferojnë të mos na kenë pranë, por të dinë se po hedhim hapa të sigurtë e se mundi do të na shpërblehet. Kjo, sepse e shohin vendin tonë pa të ardhme. Pa dashur të tregohem pesimiste, pasi besoj se Shqipëria, edhe nëse vonë, do të arrijë nivelin që i takon. Ky fenomen i ikjes masive sot të forcës intelektuale, punëtorë, të trurit e të krahut të punës vjen si rrjedhojë e një sistemi jomeritokratik, bazuar shpesh në nepotizëm.

E kur mbizotëron kjo mendësi ku diferencat e pozicioneve në strukturat e ndryshme s'do të bazohen në meritë njeriu ç'ekuilibrohet. Prandaj zgjedhin të largohen, të dinë se puna e tyre do të gjëjë vlerësim e shpërblim. Sa i përket synimeve të mia, do të doja të qëndroja për disa vite mbas rrugëtimin akademik, e të punoja në profesionin tim këtu për t'i dhënë vlerën praktike diplomës. Gjithsesi, në asnjë moment nuk e përjashtoj Shqipërinë.

Si një juriste e ardhshme a mendon se drejtësia shqiptare ka nisur një kapitull të ri me ndryshimet në sistemin?

Nuk jam në gjendje të vlerësoj prej këtu sa impakt ka pasur e ashtuqajtura reformat në drejtësi në sistemin aktual. Ndonjëherë më duken si skena teatrale. Rishikimi i deklarimeve të pasurisë, vetë

kompetenca e gjykatësve, publikimi i disa sekuencave që tregojnë sesi po vepron reforma. Mendoj se është më e thjeshtë në formulë dhe më e komplikuar në aplikim. Problemi është ai i përhershmi, duhet një luftë e fortë anti-korrupsion dhe mekanizmat efektive për të garantuar ndarjen e pushteteve. Reformimi duhet të vijë gradualisht dhe progresiv që të funksionojë.

Nëse do ishit gati dhe me diplomë, do të merrnit iniciativën të aplikonit në strukturat e reja të drejtësisë në Shqipëri? Apo, ende nuk kenë besim?

Më duhet të pranoj se nuk kam akoma një përgjigje për këtë pyetje. Varet nga shumë faktorë, nëse do të ishte një pozicion ku të mund të kisha impakt sado pak në përmirësimin e vetë strukturës. Pozitivja në Shqipëri është që ka akoma shumë për të bërë, në një kohë që në Perëndim është më vështirë të sjellësh diçka të re, goftë kjo edhe një përmirësim.

Alba preferon më shumë pjesën penale, apo atë civile? Pjesën avokatore, apo atë akuzuese.

E kam të vështirë të zgjedh, pasi personalisht jam e intriguar nga e drejta penale fiskale. Është kryesisht edhe pjesa e avokatorëve që më tërheq. Kjo pasi, pa avokaturën s'mund të funksionojë akuzat. Procesi gjyqësor s'mund të zhvillohet pa mbrojtësin, është një formë hero. Një shembull: Më vjen ndër mend procesi i "Le Brigate rosse" në Itali, ku procesi gjyqësor s'mund të zhvillohej pa një avokat për palën mbrojtëse, por që në rastin në fjalë askush nuk guxonte, dhe i vetmi që pranoi e i dha terren veprimi akuzës ishte avokati Fulvio Croce, që më pas u vra nga vetë "Brigate rosse" dhe u konsiderua hero. Nëse do të më duhej të zgjidhja, do të thosha kryesisht civilen, e drejta e obligacioneve, apo detyrimeve është shumë e bukur.

Çfarë perceptimi vjen nga jashtë për Shqipërinë dhe vendin tonë? A gjenden shpesh edhe në pozita sqaruese kur flitet për Shqipërinë?

Gjendem jo rrallë herë në

pozita të tilla. Shpesh njerëzit kanë tendencën t'i besojnë klisheve dhe është bukur kur i tregon se "Taken" s'është veçse film (po e marr si shembull klisheje) dhe se realiteti është, këtë herë më rozë se sa edhe shfaqet. Gjithashtu e ndiej të nevojshme të shpjegoj këtu edhe imazhin tonë negativ mbas '90-tës jashtë vendit. Gjithsesi perceptimi s'është gjithmonë negativ. Shpesh herë e shohin Shqipërinë si një vend ekzotik të Evropës. Si një vend mesdhetar, na mendojnë gjaknxehtë, thënë kjo, jo në kuptim pëxorhorat, dhe plot jetë, ashtu siç jemi. Dhe kjo me pëlqen. Disa të tjerë e liden me figurën e Nënë Terezës, disa me miq shqiptarë që ja kanë dalë në fushat e tyre.

Është e vështirë të superosh nivelin e shkollës së drejtësisë në Francë?

Unë studioj në Panthéon Assas, një shkollë që kryeson klasifikimin në fushën e drejtësisë në Francë, kjo vjen me një çmim, pasi kërkesat akademike janë shumë të rrepta dhe vlerësimet tepër rigorozë, ndonjëherë më tepër se duhet mendoj. Por, Franca është e bazuar në një sistem arsimor ku e drejta i jepet gjithkujt, e ku filtri bëhet çdo vit. Kjo e bën të vështirë, sepse asnjëherë s'mund të jesh i qetë, por e bën edhe të vërtetë në vlerësim. Është bukur të dish se e ke merituar.

Protesta ka patur edhe në Francë, por edhe në Shqipëri. Ju kanë lënë ndonjë përshtypje të veçantë ato?

Mbas pozicion të ndryshëm për të dyja, pasi koniukturalisht janë të ndryshme. Në Shqipëri kam mbështetur dhe do mbështes plotësisht protestën e studentëve, e konsideroj të drejtë dhe të mirëorganizuar Kërkesa për arsim falas është legjitime, pasi e drejta për t'u shkolluar s'mund të bazohet në një filtër mbi situatën financiare të gjithsecilit. Për më tepër, që tarifat në fuqi janë të krijuara. Është për të ardhur keq qëndrimi dhe justifikimi, fshetur pas mekanizmave procedurale e buxhetore të pakuptimita. Por, as Roma s'është bërë në një ditë. Duhet parë si një tentativë e parë dhe pozitive.

Kejvina "braktis" Ermalin? Zbulohet konflikti me moderatorin

Kejvina Kthella është një nga femrat më të bukura e më seksi të show bizz-it shqiptar. Velina është kthyer në një nga vajzat më të komentuar dhe çdo e re rreth modeles përbën interes për publikun.

Mirëpo "Xing.al" portali i emisionit ka shkruar se Kejvina e ka braktisur emisionin në mes të sezonit për shkak të një konflikti me moderatorin Ermal Mamaqi.

Zbulohet se arsyeja e konfliktit ka qenë për shkak se Kejvina nuk ka marrë vëmendjen e duhur dhe dedikimin e duhur nga Ermal Mamaqi. Për këtë arsye velina ka vendosur të largohet nga emisioni që e bëri të famshme për publikun. Mos vallë është ndonjë shaka, sepse po t'i hedhim një sy 'Instagramit' të tyre, Kejvina dhe Ermali ndiqen në 'Instagram' dhe velina e ka ende të shkruar në BIO-n e saj në 'Instagram' se është pjesë e emisionit.



Kush është ai që e ndjek? Luana 'arratiset' përsëri

Duket se pushimet nuk kanë për të mbaruar për moderatorin e njohur Luana Vjollca. Pas kthimit nga Maldivet, ku thuhet se ishte me partnerin e saj Krenarin, ndonjëse vetë Luana u tregua e kujdesshme të mos postonte foto me të, moderatorja ka nisur pushimet e tjera. Përmes një postimi në 'Instastory' vetë Luana ka publikuar foto nga aeroporti "Nënë Tereza" dhe shkruan "I do robi ca pushime pas pushimeve". Me siguri fansat ishin kureshtarë të mësonin se për ku ishte nisur Luana dhe ajo nuk u vonua shumë pasi e zbuloi këtë detaj. Nëse mendoni se destinacioni i radhës do ishte sërish ndonjë vend tropikal, gaboheni pasi Luana ka shkuar në Londër. Me kë mund të jetë 'arratiset' moderatorja? Ndoshta do e zbulojmë në ditët në vijim!



Nuk e prisnim! Ronela Hajati sapo na tregoi emrin e të dashurit të saj

Prej muajsh Ronela Hajati dhe Young Zerka janë përfolur për një romancë. Asnjëri prej tyre nuk ka pranuar publikisht asgjë dhe shpesh shprehen se janë miq e bashkëpunëtorë mjaft të mirë, por kjo nuk i ka ndaluar mediat rozë të aludojnë për shenjat e një lidhjeje të mundshme. Ndoshta s'do e marrim vesh asnjëherë nëse kanë qenë ose janë të lidhur, por së fundmi Ronela i ka konfuzuar të gjithë me një foto në 'Instagram' ku ka shkruar emrin e të dashurit.

"Emri i të dashurit tim është Diego", ka shkruar këngëtarja pranë fotos, por me siguri është ndonjë dëgjues për shaka ose mund të jetë pjesë nga projekti i saj i ri.



890 likes

ronelahajatiofficial My boyfriend 's name is Diego

Xheni i 'BB9' ka bërë operacione plastike? Ja përgjigja që u ka dhënë fansave

Xheni është një nga ish-banoret më tërheqëse dhe njëkohësisht më të përfolura pas përfundimit të 'Big Brother 9'. Shpesh herë ajo u komentua për "lidhje-ndarjet" me Benardin e BB9, por më pas ata i ndanë rrugët me njëri-tjetrin. Ajo është shumë aktive në rrjetet sociale dhe loja "pyetje-përgjigje" në 'Instastory' është një ndër rubrikat që i pëlqen shumë.

Ish-banorja 'Big Brother', ka pranuar hapur së fundmi se ka bërë ndryshimin e madh në pamjen e saj. Teksa i përgjigje fansave kuriozë në 'Instastory', njëri prej tyre vuri re se Xheni kishte bërë hundën, dhe nuk ngurroi ta pyesë për këtë. "Xheni, mos ke bërë hundën? Nëse po, dukesh shumë e bukur" - i shkruan ai, të cilit ish-banorja ia kthen: "Po, faleminderit", duke pranuar publikisht ndryshimin e saj në pamje.



STUDIMI

Në raportin zyrtar për Institutin e Shkencave në 3 shtatorin e 1950-ës, Sabiha Kasimati përshkruhej se "as politikisht as ideologjikisht" nuk kishte gjë të përbashkët me sistemin dhe madje shihej se as që mund të korrigohej.

SABIHA KASIMATI

Zëri që u shua në mesnatë

Fatmira Nikolli

Kur më 1927, në moshën 15-vjeçare, Sabiha Kasimati vinte për herë të parë në atdhe, nuk e dinte se ky udhëtim do ta shënjonte përgjithnjë jetën dhe vetë fundin tragjik të saj. Rruga e përshkuar me karvanët e kohës, tronditjet a frika e sulmeve, sot, duket se i paracaktoi fatin në dy dekadat e ardhshme, me gjurmët që luajtën në vendin prej ku kishte rrënjët.

Ende adoleshente, e rritur në Adrianopojë (Turqi) ku kishte lindur në kohën që Shqipëria shpallte pavarësinë prej Perandorisë Osmane, asgjë prej saj, nuk të fliste për një vajzë të Orientit. I ati, Abdurrahmani, ishte mjek në Zë, me lidhje të thella me elitën intelektuale e politike të shtetit shqiptar që rrekej të modernizohej.

Kasimatët u vendosën në Korçë dhe Sabihaja, si i vëllai, filloi Liceun Kombëtar. Në shkollën e njohur si Liceu Francez ajo mori mësim nga një staf i ardhur nga perëndimi, me mësues shqiptarë e frëngë, që përtej programit mësimor bazë në lëndë të shkencave ekzakste e shoqërore, orientonin edhe bazat e formimit të nxënësve si qytetarë. Niste që në atë moshë për Sabihanë, ndjekja e jetës kulturore dhe njohja me lirë e mendimit e veprimit.

E ardhur nga një familje e mirë, njohëse e disa gjuhëve të huaja, mes të cilave fliste rrjedhshëm frëngjishten, me bukurinë dhe ëmbëlsinë që përcillte portretin e saj, vajza e vetme e shkollës ishte e çlirët, çapkëne, e zgjuar dhe me rezultate të larta në mësim. Duke qenë një ndër të paktët institucione arsimore të kohës, mendohet se Sabihaja mund të jetë njohur aty, edhe me Enver Hoxhën që ka kryer të njëjtën shkollë e që vite më pas do të instalonte regjimin komunist në vend.

Pasi mbaroi Liceun, ajo filloi punën në Shkollën Amerikane të Kavajës më 1932, më pas u rikthye në Lice si mësuese e klasave të ulta, por për shkaqe shëndetësore e la shpejt dhe u punësua si mësuese e frëngjishtes në Tiranë në Institutin Femëror "Nana Mbretëshë". Më 1936 Sabihanë e gjejmë në Torino të Italisë, ku ka nisur studimet e larta në Fakultetin e Shkencave të Biologjisë, me bursë nga shteti shqiptar. Natyra e saj dhe guximi për të ngritur zërin del herët në pah, kur si studente nënshkruante një kërkesë drejtuar Ministrisë shqiptare të Arsimit që t'u jepte mundësinë nënshtrimit të saj, të



Përndjekja e shkencëtares, dalin studimet e dokumentet: takohet me kaptera dhe gra të cilat kanë burrat kriminelë me damkë


jepnin provime edhe në sezonin e vjeshtës, duke pasur parasysh problemet me gjuhën italiane e mungesën e teksteve. Punën e saj të parë shkencore, nëse mund ta llogarisim të tillë tezen e diplomës, ia kushton vendit të origjinës, nën titullin "Fauna Iktiologjike e ujërave të ëmbla të Shqipërisë". Shqipëria e pushtuar nga fashistët gjatë kohës që ajo ishte në Torino vijon të jetë nën pushtim, kur Sabihaja kthehet nga studimet. Më 1941, është mësuese e shkencave, kimisë dhe higjienës në Shkollën Normale Femërore "Nana e Skënderbeut". Dy vite më pas detyrohet të shpëtojë për shkak të tuberkulozit dhe nis kurimin në Itali.

Por, para se të ikte, kishte hedhur hapin e parë, në formësimin e njëjës prej ideve më të qenësishme si grua e shkencës. Ishte ftohtë në 12 janarin e 1943-it, kur mësuese Sabihaja takonte kryetarin e Institutit Mbretëror të Studimeve Shqiptare, Ernest Koliqin, me të cilin njihëj prej kur ajo ishte studente e ai ministër i Arsimit. I thoshte në vija të përgjithshme atë që më pas ia paraqiste përmes një projekti të detajuar në letër. Ajo propozonte krijimin e "një koleksioni zoologjik, tue filluar nga

RAPORTI I "PRURSES"

Në raportin e bashkëpunëtores së Sigurimit të Shtetit me pseudonimin "Prurësja", më 27 prill 1950, del që Kasimati i ka rrëfyer se "...Tash kemi shpënë në shtypshkronjë një broshurë për t'u botuar; është vepra ime, pjesën më të madhe më ka ndihmuar dhe Çabeu. Sot këtë broshurë vajta dhe e mora nga shtypshkronja. Ju thashë atyre se e kërkon Komisioni i Kontrollit..."

Dega e Iktiologjisë", për të cilën kishte mbrojtur diplomën; përgatijten e "një erbario" mbasi flora shqiptare, ka provuar interesimin e botanistëve më të shquar, sidomos gjerman dhe t'Europës përgjithësisht" si edhe mbledhjen "në bashkëpunim me Drejtorinë e Minjereve pranë Ministrisë s'Ekonomisë, e llojeve të ndryshme



të mineraleve dhe të fosileve që gjinden në shtresat e tokës në Shqipëri". Sabihaja i thoshte Koliqit se për këtë duhej një bibliotekë me vepra shkencore, bibliografinë e së cilës e kish bërë gati dhe se duhej ngritur edhe një laborator studimesh mikroskopike për kërkime shkencore. Duke kuptuar mangësitë shqiptare në këtë lami, vërente se "do të kishin një randësi të lartë nga pikëpamja gjuhësore... të caktoheshin njëherë e mirë në rast se nuk ekzistojnë emrat dhe termat teknike shqipe, gjë që do të pasuronte mjaft gjuhën t'onë kombëtare". Po ndërtonte një këshill të shkretëtirë. Dhe e dinte. Atëkohë ishte veçse 31 vjeçe, e re, e bukur, e zgjuar, elegante, e veshur me sqimë, e shkolluar, e formuar, ishte e bija e një mjeku, e ishte edhe motra e një mjeku, e një inxhinieri dhe një juristi. Ishte një grua e lirë, në një qytet që rrekej të linte pas fashistët, e të mësohej me nazistët. Por teksa në Tiranë gjëmonin armët, vizioni i saj shkencor e injoronte, a mbase më mirë e sfidonte luftën. Një muaj pas propozimit të saj, në messhkurthin e të njëjtit dimër, Instituti Mbretëror i Studimeve vendos të ngrejë një muze të shkencave dhe ngarkon Sabihanë të merret me të. Ajo e nis punën me përshkrimin e materialeve që dureshin dhe librave për bibliotekën e muzeut. Ika e pushtuesve, çlirimi i vendit dhe instalimi i një sistemi të ri politik nga fitimtarët e gjem atë të përkushtuar në kërkimin shkencor. Është në Institutin e Studimeve Shqiptare dhe më

1946 bashkë me Gjergj Komninon dhe grupin e drejtuar nga Eqrem Çabej, është marrë me skadat në gjuhën shqipe për termat e shkencave të natyrës. Është ende aty kur qeveria e re e riorganizon Institutin më 1947 dhe vë në themel të punës së tij ideologjinë marksiste-leniniste. Dokumentet shteruese që kanë shqyrtuar studiueset Ledia Dushku dhe Doris Pasha për studimin mbi të cilin bazohet ky artikull, nuk japin të dhëna për raportet që ka pasur Kasimati me Institutin e Studimeve gjatë regjimit komunist. Prej tyre, kuptohet vetëm se nga qeveria e ardhur pas çlirimit nuk shiheshin me sy të mirë shtresat e intelektualëve të pasqaruar mbi pozicionin e tyre gjatë luftës, të shkolluarit në perëndim, ata që e kanë mbështetur pushtuesin ose ata që kanë qenë indiferentë, siç kishte qenë biologja Kasimati. Por nevojja për zhvillim ekonomik i jepte rëndësi shkencave të natyrës dhe Kasimati si e para iktiologje boton në "Buletinin e Shkencave" më 1948 artikullin "Probleme të peshkut dhe të peshkimit në vendin tonë". Pasi jepte shumëlloshmërinë e peshqve, cilësitë e ujërave dhe mundësitë prodhuese të tyre, numëronte pa drojë për kohën edhe mangësitë e shumta, që nga varkat, transporti e konservimi. Veç anës kritike, studimi i Sabihës ofronte edhe zgjidhje të mundshme duke propozuar që nga organizimi i peshkimit deri të përdorimi i mjeteve moderne a citimi i ligjeve ndërkombëtare. Janë të guximshme kritikat e saj të drejtpërdrej-



LIBRI I ZHDUKUR

Ndonëse ishte procedurë që të dënuarve nga regjimi ju ndalohej dhe ju bëhej vepra karton, për librin e mësipërm, nuk ka asnjë gjurmë as në skedat dhe dokumentacionin e Bibliotekës Kombëtare. Hipotezën e përhapur se studimi i Sabiha Kasimatit është përveçuar dhe është botuar më 1958, me të njëjtin titull nën autorësinë e tre emrave të tjerë, studiueset Ledia Dushku dhe Doris Pasha e kanë gjetur të vështirë ta provojnë.

ta, nëse kemi parasysh se regjimi i kohës, në vitet 1946-1947 e kishte treguar tashmë natyrën e tij hakmarrëse ndaj kundërshtarëve, madje vetë Sabinaja kishte njohur tronditjen e humbjes së miqve të afërt.

Me gjithë erën e frikës që ndjehet mes intelektualëve, ajo vijoi punën për përgatitjen e monografisë "Peshqitë e Shqipërisë" siç mësohet nga plani i punës së Institutit të Shkencave. Më 1948 botimi i veprës u shty dhe Sabinaja vijoi ekspeditat për peshqitë e ujërave të kripur në Shqipëri më 1949. Studimi u përfundua dhe u botua më 1950, sic del në dritë në të dhënat e Institutit të Shkencave dhe dokumentet e Sigurimit të Shtetit, por në mënyrë të pashpjegueshme, në ditët tona nuk ka mbërritur asnjë kopje e tij. Në raportin e bashkëpunësorëve të Sigurimit të Shtetit me pseudonimin "Prurësja", më 27 prill 1950, del që Kasimati i ka rrefyer se "...Tash kemi shpënë në shtypshkronjë një broshurë për t'u botuar; është vepra ime, pjesën më të madhe më ka ndihmuar dhe Çabeu. Sot këtë broshurë vajta dhe e mora nga shtypshkronja. Ju thashë atyre se e kërkon Komisioni i Kontrollit..." Ndonëse ishte procedurë që të dënuarve nga regjimi ju ndalohej dhe ju bëhej vepra karton, për librin e mësipërm, nuk ka asnjë gjurmë as në skedat dhe dokumentacionin e Bibliotekës Kombëtare. Hipotezën e përhapur se studimi i Sabiha Kasimatit është përveçuar dhe është botuar më 1958, me të njëjtin titull nën autorësinë e tre emrave të tjerë, studiueset Ledia Dushku dhe Doris Pasha e kanë gjetur të vështirë ta provojnë.

Shkollimi në Perëndim, origjina familjare, formimi liberal, natyra e guximshme dhe e çlirët për të thënë hapur mendimin e saj kritik qoftë

ky në kundërshtim me propagandën e shtuar të regjimit, rrethi i njerëzve me të cilët shoqërohej disa prej të cilëve me të afërmit në burgje, besohet se ishin arsytet që e vendosën Sabinaja Kasimatit në vëzhgimin e Sigurimit të Shtetit. Por sa i takon kohës që filloi përndjekja, sa zgjati dhe çfarë e përcaktoi vendimin për të, ka shumë pikëpyetje. Dritëhijet janë të mëdha duke qenë se në Arkivin e Sigurimit nuk është gjetur një dosje me emrin e saj dhe të dhënat për Sabinanë janë marrë nga dosjet e atyre me të cilët ajo shoqërohej. Në raportet e bashkëpunësorëve të Sigurimit, ajo shfaqet kritike ndaj reformave të qeverisë, politikave të ndjekura, varfërisë dhe e shprehte hapur pakënaqësinë ndaj pushtetit, medias së kontrolluar prej tij madje edhe fjalimeve të mbajtura nga një njeri i pushtetshmë si gjeneral Mehmet Shehu mbi moralin e të rinjve. "Shtypi dhe radio thonë se amerikanët i ushqejnë t'arratisunit me mish kali, por ky i këtyre kutive këtej ç'është vallë? Se neve nuk i kemi as këto. Rrallë na bie t'i kemi, edhe këto me ndërmjetësinë e miqve tonë", shprehej ajo sipas raportit të spiunes. Sabinaja e kritikonte regjimin më 1950 me të njëjtin gjuhë që mund ta bëjë dikush sot në liri, kur thoshte "udhëheqësit tanë kur duan të vënë ndonjë tjetër në Komitetin Qëndror që e kanë më të besimit, heqin ndonji që e kanë pasur... I venë ca akuzat të kota, në qoftë se ay i ka zbatuar, prapë me urdhërin e tyre i ka zbatuar". Janë të guximshme për kohën sa mendimet edhe qëndrimet e saj, kur rezultoi se Kasimati ishte në dënim të mënyrës se si pushteti vepronte me qytetarët. "Prurësja" e zgjedhur nga Sigurimi ta ndiqte raportonte se Kasimati "takohet me kapëtra dhe gra të cilat kanë burrat kriminelë me damkë". Në raportin zyrtar për Institutin e Shkencave në 3 shtatorin e 1950-ës, Sabinaja Kasimati përshkruhej se "as politikisht as ideologjikisht" nuk kishte gjë të përbashkët me sistemin dhe madje shihej se as që mund të korrigjohet. Ishte koha që iluministët francezë zëvendësoheshin me Marksian.

Por vrojtimit disaveçar i vjen fundi. Më 20 shkurt 1951, pas vënies së bombës në Legatën Sovjetike, Sabinaja do të arrestohej bashkë me 21 intelektualë të tjerë të akuzuar për sulm terrorist. Dosja hetimore i numëronte disa "mekate": "gjatë okupacionit ka pasur marrëdhënie me elementë fashistë, shqiptarë e italianë. Mban qëndrim armiqësor ndaj pushtetit, flet kundër reformave dhe mban kontakt me elementë armiq... Ka pasur kontakt me deputetin angazhues Lester Hutchison. Ka mbajtur kontakte me njerëz të misionit anglez... dhe me J.S. Payne me të cilin ka pasur lidhje të ngushta. Armike e betuar e pushtetit të

sotëm. Ka urrejtje karshi tij dhe sidomos karshi komunistëve, kritikon moralin komunist etj".

Procesverbalet i mbajtur nga Gjykata Ushtarake, pretendon se Kasimati e ka pranuar një pjesë të akuzave dhe ajo citohet të ketë thënë: "Kam qenë kundër pushtetit popullor sepse nuk përputhet me ideologjinë time. Unë nuk kam qenë kurrë e mendimit, që me akte revolucionare të arrihet në komunizëm, jam lidhur me një grup shokësh të cilët edhe ata kanë qenë armiq të partisë Komuniste. Ndër shokët e grupit tim ka pasur edhe njerëz që mendonin se duhet të hidheshin në aksione kundër pushtetit. Unë vetë nuk kam kryer ndonjë atentat dhe as që kam marrë pjesë në ndonjë mbledhje, ku është marrë vendim për akte terroriste. Ka bërë vakti që të kem folur se një luftë e re është e paevitueshme dhe se kjo është në interes të popullit shqiptar". Një javë pas arrestimit, Sabinaja dhe 21 intelektualët e tjerë ekzekutohen, pa ju dhënë mundësi të kundërshtojnë vendimin. Studiuesit e vënë në dyshim procesin hetimor dhe kanë arritur në përfundim se janë falsifikuar procesverbalet nga Gjykata Ushtarake, pas ekzekutimit pa gjyq të 22 pafajshmëve, mes të cilëve edhe Sabinaja.

Vetëm një javë e përcollti nga jeta në liri drejt vdekjes. Ajo ende nuk i kishte mbushur 39 vjeçe, kur ia prenë jetën në mes. Familjarët besojnë se u vra ngaqë në një letër dërguar Enver Hoxhës, ose në një takim me të, e ka kritikuar për qeverisjen dhe se që pikërisht ai që ia vuri emrin në listën e atyre që duheshin ekzekutuar. Megjithatë janë konsultuar me të gjitha arkivat e vendit, Ledia Dushku dhe Doris Pasha, mbi studimin e të cilave bazohet ky artikull, nuk kanë gjetur një dokument që vërteton një letër të tillë. Familjarët kanë rrefyer edhe se një zyrtar i lartë komunist, mik i saj, e kish ftuar në kafë për ta këshilluar "duhet të mbyllësh gojën jo me karficë, por me babushkë..." Rrefimet nuk mjaftojnë për të kuptuar çfarë ka menduar, çfarë ka dashur të bëjë, sa i ka dhembur dhe si e ka luftuar kohën. Në fund të një studimi që ka shfrytëzuar disa burime, e vetmja gjë që mund të thuhet, është se Shqipëria komuniste nuk kishte vend për një grua të lirë, që kishte qenë indiferente gjatë luftës e që ishte kritike pas luftës, për atë që po bëhej atdheu i saj. Vajza që dikur kishte lënë Turqinë e mandej Italinë për të bërë muze shkencash e studime shkencore, që tepër e lirë për ta lejuar të jepte shembullin e saj në Tiranë që kërkonte një tjetër model të gruas komuniste. Vajza e re që erdhi e struktur në krahët e të atit, nuk u la të thinjë. Mbeti përjetësisht e re me pengjet e atyre që nuk e lanë t'i bënte. 40 vite pas vdekjes, kur regjimi po shkërmonte një vendim i Gjykatës së Lartë e shpall të pafajshme. Sot, "Nder i Kombit", 67 vite pas natës kur zëri i saj u shua përgjithnjë duke lënë pas heshtje, pikëpyetje e barëren e dhimbjes, një godinë e gjelbër në rrugën e Tregut Elektrik në kryeqytet, mban në ballinë emrin e saj. Në krah të majtë të derës, një kënd kujtese shfaq portretin e saj me një buzëqeshje të ndalur në kohë. Duket sikur amaneti i Sabinasë ka marrë jetë, por tanimë duke i njohur meritën. Për të "evolucioni është në natyrën e gjërave" dhe koha provoi se kishte të drejtë.

KONFERENCA

Kur Sigurimi i shtetit përndiqte shkencën



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Projekti PERFORM - Shkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme bashkëpunuan përgjatë 2018 për ndërtimin e një narrative mbi rolin e shkencës, elitave intelektuale dhe kërkimit shkencor në vitet e para të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri. Aktiviteti përmbyllës i projektit u zhvillua në mjediset e Akademisë së Shkencave, aty ku zuri fill një vit më parë dhe trajtoi në mënyrë multidisiplinore profilet e akademikëve Gjergj Kokoshi, Eqrem Çabej, Sabinaja Kasimati, Arshi Pipa, Aleks Buda, Petraq Pepo, Gjovalin Gjadri, Petraq Qafoku dhe Kolë Kamsi. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe nismëtare e projektit tha mes të tjerash se: "Në punën me arkivin, Autoriteti synon përcaktimin e metadatave dhe përpunimin arkivor që i jep përparësi mbështetjes së axhendës së studimit shkencor, e cila është konsultuar dhe bashkërenduar me organizma akademikë dhe të memories. Kuadri konceptual i punës është ndërtuar në formë matricore dhe ka të bëjë me tematikën, geografjinë e ngjarjeve dhe kontekstualizimin e tyre". Mbështetës i projekteve mbi kujtesën, Adrian Maitre, Ambasadori i

Zvicrës në Shqipëri, përshëndeti aktivitetin dhe bashkëpunimin, duke e vënë theksin të rëndësia e nxjerrjes në dritë e historive të patreguara dhe puna sistematike për zbulimin e së shkuarës. "Synimi kryesor për fuqizimin e komunitetit të shkencave sociale dhe mbështetja e iniciativave të ndërmarrja nga grupet e studiuesve me aktorët e tjerë në shoqëri, përfshirë sektorin publik, privat, shoqërimë civile dhe median u materializua me platformën online dhe botimin dygjuhësh", u shpreh Martin Dietz, drejtues i projektit PERFORM.

Përgjatë një viti jo me pak sfida, nisura u finalizua me studime të genëshme, duke rishqyrtuar mbi baza profesionale figura dhe personalitetet të shkencës; duke ofruar akses në arkivat e AIDSSH-së dhe shpërndarë këtë informacion në një platformë ndërvepruese komunikimi dhe botuar në dy gjuhë studimet tënojne, për të rinjtë shqiptarë dhe të interesuarit e shumtë jashtë vendit. Huluntimi i rolit të shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954) bashkoi punën kërkimore arkivore me misionin e Autoritetit për informimin e publikut dhe ruajtjen e kujtesës historike, për hapjen e dialogut publik mbi të

shkuarën. Personalitetet e studiuarra, qasja shkencore dhe metodologjia u prezantuan nga historiane Prof. As. Dr. Sonila Boçi, drejtuese e grupit të studiuesve. Me radhë, kërkuesit shkencorë paraqitën punimet e tyre dhe qasjen e përgjeshur për trajtimin e rolit të ish-Sigurimit të Shtetit si arma më e fuqishme e ruajtjes së pushtetit të Partisë-Shtet mbi shkencën dhe përfaqësuesit më në zë të saj. Prof. As. Dr. Albert P. Nikolla, Dr. Andi Pinari, Prof. As. Dr. Ledia Dushku dhe Prof. Enriketa Pandejmoni-Papa bashkëpunuan me një grup të rinjsh të përgjeshur për të finalizuar punimet e tyre. Studentët Doris Pasha, Enxhi Beka, Indrit Qejajaj, Joana Doda dhe Kristi Kolçe ishin

pjesë e paraqitjeve dhe ndanë me të pranishmit përvojën e studimit të personaliteteve në fjalë, nëpërmjet dosjeve të survejimit. Platforma ndërvepruese e komunikimit www.dosjet.gov.al dhe libri "Kur Sigurimi merrej me shkencën" u bënë të njohura për të pranishmit nga Ardita Repishti, Fatmira Nikolli dhe Denis Sahatçiu, të cilët, përmes ekspertizës përkatëse prezantuan mundësitë e njohjes me informacionin mbi dosjet e Sigurimit nga të rinjtë, studiuesit apo të interesuarit e tjerë. Nxjerrja në dritë e informacionit deri dhe sekret dhe rikrijimi i kuadrit historik, nëpërmjet kërkimit të mbështetur shkencor, duke dhënë profilet e personaliteteve, duke ndërtuar kohështrirjen e jetës së secilit, duke e gërshtuar atë me tablonë historike, politike, ideologjike e shoqërore të kohës është hapi i parë. Intelektualët akademikë të dhjetëvjeçarit të parë të komunizmit do të pasohen nga profilet të intelektualëve të dhjetëvjeçarëve pasues dhe tematika të

tjera. Platforma do të pasurohet në vijim me informacion mbi Sigurimin e Shtetit, të vendosur gjithnjë në kontekst historik, duke qenë e aksesueshme për të gjithë, shqiptarë e të huaj dhe e dobishme në disa nivele njohjeje.

Opinion i Ditës

"Patate e nxehtë" apo "hallvë e ftohtë"?

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

...paparashikueshmërinë e saj të rrezikshme, për shkak dhe aty këtu të një alergjie të pavend për "Kutia e Pandorës" po përdorim termin "patate e nxehtë"; veçse po nuk u ndal në kohë, ajo mund të na çojë sërish të kutia famëkeqe.

Shumica dërmuese e ekspertëve dhe analistëve më të njohur, por dhe përvoja ndërkombëtare e dekadave të fundit tregojnë bindshëm arsyet /faktorët e shumtë e seriozë përse korrigjimi i kufirit, me të gjitha sinonimet e tij, është "patate e nxehtë" madje përvëluese.

Në radhë të parë, bëhet fjalë për një temë shpërthyes në një rajon si Ballkani, të tejmbushur me drama dhe tragjedi që kanë ardhur prej rivendikimeve territoriale dhe kufitare. Ja pse 25 vitet e fundit, SHBA dhe BE hoqën nga axhenda dhe fjalori politik çdo ide mbi korrigjimin/ndryshimin e kufijve. Në vend të tyre ato vendosën parimet/standartet demokratike, konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, mbrojtjen e pakicave, etj. Është e vërtetë se proceset e mbështetura mbi këto parime kërkojnë shumë kohë e durim, sepse janë plot sfida; por, po aq e vërtetë është se çdo alternativë tjetër të çon në rrugë pakrye dhe me kosto pakrahasueshmërisht të larta.

Është "Patate e nxehtë" sepse shtetet e Ballkanit, me gjithë progresin në 20 vitet e fundit janë e do të mbeten ende shumë larg vendeve Nordike dhe të Benelux; ndonëse, siç është përmendur në një shkrim të mëparshëm, vetëm për një këmbim (swap) të një minienklave me 10 ha hektarë tokë djerrë dhe të detyruar nga terreni në kufirin Belgjikë - Holandë u deshën dy vjet bisedime dhe procedura teknike e ligjore, edhe pse në një atmosferë miqësore!

Korrigjimi i kufirit është "patate e nxehtë" sepse askush nuk mund të parashikojë efektet zinxhir në rajon e më gjerë; duke filluar nga serbët e Bosnjës që qysh tani kanë paralajmëruar kundërveprimin e tyre, shqiptarët në Maqedoni dhe gjetkë; pa haruar "konfliktet e ngrira" në Gjeorgji, Nagorni Karabak dhe gjetkë që mezi presin sebebin "të shkrijnë".

Mirëpo, kush dhe cila marrëveshje mund t'i mohojë dhe ndalojë këto pretendime dhe rivendikime kur precedenti të jetë gati? Me forcë dhe imponim? Po e drejta ndërkombëtare?

Si dalje nga ky qerthull përmendet shpesh argumenti se Kosova është rast "sui generis". Në fakt, e tillë ishte kur filloi ndërhyrja ushtarake e NATO-s pa lejen e OKB-së dhe deri në shpalljen e Pavarësisë, për shkak të genocidit të pashembullt të Millosheviçit. Por ajo nuk mund të jetë gjithnjë "sui generis",



sepse nuk ka asnjë bazë juridike dhe praktike. Përkundrazi, duam s'duam, kështu si po veprohet, rreziku është që korrigjimi i kufirit, nëse realizohet, të kthehet në "rast universal". Kjo do t'i vinte për shtat vendeve të tjera me probleme të ngjashme dhe sidomos Rusisë; kjo e fundit është shprehur qartë qysh 10 vjet më parë se mund ta njihë Kosovën, por vetëm nëse ajo cilësohet si "rast universal".

Më tej, "korrigjimi i kufirit" është "patate e nxehtë", sepse deri tani situata nga Presidenti Thaçi është paraqitur vetëm rozë, me pohime pozitive, se do na njohë Serbia dhe OKB-ja, etj; sepse ai mendon dhe flet vetëm për sot e jo për nesër, për të mirat dhe jo të këqijta, për përfitimet dhe jo për kostot, për nënshkrimin, por jo zbatimin. Me një fjalë na tregon vetëm se çfarë duhet bërë por jo sa dhe si mund të realizohet kjo në praktikë.

Dhe ditët e fundit, ndonëse me tone më realiste kundërshtoi çdo ndryshim kufiri, Presidenti Thaçi tregoi se çdo të marrë Kosova, por jo çdo të japë, siç ndodh rëndom dhe në diplomaci dhe që Serbia do ta kërkojë në kuadrin e Marrëveshjes historike!

Është "patate e nxehtë" sepse në Kosovë e Shqipëri, në institucionet kryesore drejtuese si dhe midis shumicës dhe opozitës ka një ndarje dhe mungesë të theksuar konsensusi, veç konfliktualitetit të tyre në përgjithësi; për pasojë, efektiviteti dhe besueshmëria e tyre si aktorë/faktorë politikë mbetet tejet e cunguar.

Por, për fat të mirë, zhvillimet e fundit tregojnë se ka gjasa që në vend të "patates së nxehtë" të kemi, siç thuhet në të tilla raste një "hallvë të ftohtë"

Sepse koniunktura politike rajonale dhe ndërkombëtare është tejet e disfavorshme për këtë korrigjim kufiri, ca më pak të njëan-

shëm; ka një mungesë konsensusi dhe cakordim të dukshëm të faktori ndërkombëtar në përgjithësi dhe garantëve të mëdhenj të Marrëveshjes Serbi - Kosovë - BE-së, SHBA-ve dhe Rusisë. Në këto 10 vitet e fundit ato kanë pësuar ndryshime rrënjësore në strategjinë e tyre gjeopolitike; marrëdhëniet me tyre janë krisur dhe tronditur rëndë, duke prekur besimin reciprok. Kështu, nga partnere, Rusia është kthyer në "sfidë" apo në problem strategjik për BE-në, sipas Donald Tusk; kjo e fundit ndërkohë dihet se është cilësuar deri "armike" nga Trump.

Veç kësaj, BE-ja dhe vendet anëtare ndodhen nën ethet elektorale të zgjedhjeve jetike të 26 Majit të këtij viti. Kësisoj, "patatja e nxehtë" në Ballkan vetëm se do ta dëmtonte më tej imazhin, efektin dhe rezultatet e partive tradicionale. Tejet e rëndësishme, qeveritë, agjencitë përkatëse dhe media në Gjermani, Britaninë e Madhe dhe vende të tjera janë kategorikisht kundër çdo korrigjimi të kufijve. Ata kanë deklaruar në mënyrë të përsëritur se integrimi në BE është alternativa e vetme e zgjidhjes së problemeve. Pas Merkelit këtë kundërshtim e shprehur hapur më 5 mars në debatin në Dhomën e Komuneve edhe ministri britanik për Çështjet Evropiane, Sir Alan Duncan.

Mirëpo, pa 'OK'-in e këtyre vendeve, edhe Frederika Mogherini është fare e pafuqishme dhe "jashtë loje". Kujdes, ajo nuk është shefe e politikës së jashtme të BE-së, siç paraqitet në media, por vetëm Përfaqësuese e Lartë e kësaj politike. Cka do të thotë se ajo nuk mund të bëjë dhe miratojë asnjë marrëveshje pa miratimin paraprak të vendeve anëtare e padyshim, në radhë të parë, të Gjermanisë.

Aq më tepër që Mogherinit i

kanë mbetur vetëm pak muaj në atë zyrë, me një imazh të dobësuar dhe që me (mos)qëndrimet e saj e ka mbajtur "shumë me hatër" Serbinë. Vetë lideri i saj, Ish-Kryeministri italian Matteo Renzi shprehur hapur disa ditë më parë zhgënjimin me performancën e Mogherinit. Në këto kushte, kuptohet se nxitimi i madh ka të bëjë kryesisht me trashëgiminë e saj politike, që të mbahet mend për diçka.

Për sa i takon SHBA-ve, vërtet ka qarqe dhe brenda diplomacisë amerikane në favor të korrigjimit të kufirit, por shumica e analistëve dhe ekspertëve të njohur ashtu si dhe në Evropë janë kundër. Kështu, ditët e fundit, zëvendësndihmës sekretari i Shtetit, Palmer kërkoi publikisht nga Serbia të njohë Kosovën e pastaj të diskutohet për aspekte të tjera të Marrëveshjes midis tyre.

Nga ana e tij, Presidenti Trump ndodhet në pozita më të vështirësuar, i sulmuar dhe anatemuar nga të gjitha anët sidomos pas muajit Nëntor kur humbi shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve. Së fundi, dështimi spektakular në Samitin e Hanoi javën e kaluar ka hedhur hije të mëdha dyshimi në forcën dhe besueshmërinë e tij ndërkombëtare.

Natyrisht nënshkrimi i pritshëm i Marrëveshjes Serbi - Kosovë sikurse është paralajmëruar në Shtëpinë e Bardhë në Qershor është gjithë një miratim që Shtëpia e Bardhë është vërtet vend emblematik për një gjë të tillë. Por, kujdes, se historia na mëson të mos e hyznizojmë atë. Në vitin 1993 aty u nënshkrua me pompë të madhe Marrëveshja e Paqes mes Rabinit dhe Arafatit me garant Clinton dhe Husein. Por ajo nuk gjeti dot zbatim; madje, fatin tragjik të Sadatit egjiptian më 1981, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes me Izraelin në Camp David e pësoi

14 vjet më vonë homologu i tij izraelit, Rabin. Dhe përpjekja e fundit e Clinton më 2000 me Arafatin dhe Netaniah, duke i "kyçur" për ditë të tëra në Shtëpinë e Bardhë dështoi pa rezultat.

"Hallva" fillon e ftohet dhe më shumë kur mendon se në kuzhinën politike e kësaj marrëveshjeje pritet të jetë dhe Rusia. Nuk ka naivitet më të madh diplomatik të besosh se Rusia futet në lojë se "e preu" për Kosovën apo për të drejtën ndërkombëtare. Kursesi, por thjesht për ta përdorur atë si gur shahu për realizimin e jo një apo dy, por për disa objektiva madhore strategjike njëherësh në Ballkan dhe në Evropë; me pak fjalë, të marrë atë që la 20 vjet më parë, të tregojë se pa Rusinë nuk mund të zgjidhet asgjë në botë; të shkëpusë vëmendjen ndërkombëtare nga Ukraina dhe Krimea dhe ta spostojë në Ballkan; ta kthejë Kosovën një precedent universal për ta shfrytëzuar për "konfliktet e ngrira" etj; të justifikojë dhe legjitimojë praninë dhe aktivitetin e saj në Ballkan, për ta larguar dhe për ta shfrytëzuar atë për përçarjen e mëtejshme të BE-së.

Ndaj ditët e fundit zëdhënësja e MPJ-ruse e tha hapur se Rusia mbështet këtë Marrëveshje, në rast se ajo të jetë në përputhje me interesat serbe, kurse fjala Kosovë mungon.

Pyetja tjetër e realpolitikës që shtrohet është nëse ka interes Rusia vërtet për një zgjidhje të shpejtë të këtij problemi apo mund ta zvarrisë atë sipas rastit sa më shumë dhe mundësisht ta kthejë në një konflikt tjetër të ngjirë që ajo i ka shumë për zemër? Aq më tepër që asnjë lloj marrëveshjeje nuk mund të miratohet pa "bekimin" e saj në KS të OKB-së. Ja pse oferta tejet "bu-jare" ndaj saj si palë në këtë marrëveshje është "dhuratë" e paçmuar për Rusinë dhe ajo ka treguar se di të luajë dhe të "driblojë" mjeshtërisht me dhe pa top! Rusia është e fituar në të dy rastet; po qe se Marrëveshja nuk bëhet, ajo do të tregojë gishtin nga të tjerët. Ndërsa kur të arrihet një gjë e tillë, ata do të kërkojnë shpërblimin e tyre "të majmë" për rolin e tyre.

Së fundi por dhe më e rëndësishmja, korrigjimi i kufirit është "hallvë e ftohtë" se deri tani dihet nga të gjithë se dialogu të shumëpritur midis Serbisë dhe Kosovës i mungon trualli, mjedisi dhe besimi i nevojshëm për një marrëveshje të tillë. Pavarësisht kritikave në aspektin teknik, vendosja e taksave doganore 100 ndaj mallrave serbe që tashmë duhet të ndërpritet ishte një mundësi e mirë për qeverinë e Kosovës si dhe për Serbinë dhe komunitetin ndërkombëtar për të ndaluar sadoqap vrapin e për të reflektuar më drejt mbi hapat e mëtejshëm për një marrëveshje tërësore vërtet historike.

Opinioni *i* Ditës

Një kryeministër mjeran e i izoluar

Nga Bardh Spahia

(vijon nga faqja 1)

... e ka orientuar debatin tek dhuna në protestë, duke anashkaluar plotësisht arsyet që nxorën opozitën nga parlamenti, e kërkuar bashkimin e qytetarëve në shesh kundër tij, jashtë vendit po bën një figurë qesharake teksa shfaqet si europiani reformator përballë një opozite xheloze ndaj tij. Kështu, si kurrë ndonjë shtetar më parë, mori rrugën drejt Italisë e po vetëfrohët për intervista, për të thënë se mijëra qytetarët në shesh nuk janë populli i revoltuar ndaj tij, ndërsa normaliteti shqiptar ka personazhet qesharake që i sollë në kuvend si opozita që atij i duhet. Falsiteti i kësaj fasade i spikati turpshëm pikërisht në prag të intervistës së siguruar në emisionin "Porta a Porta" në kanalën kryesor televiziv publik italian. Kryeministri u kryqëzua nga komentet e pacensuruara të shqiptarëve në faqen zyrtare të programit, ndërsa në mënyrë edhe më qesharake se vetë kryeministri, dy zëvendësministra të tij, postonin elozhe për kryeministrin.

E gjithë kjo akrobaci fshihet edhe një tjetër realitet kokëfortë. Edi Rama po përploqet pa shumë sukses, të kompensojë takimet e munguara me homologë qoftë rajonale, qoftë europiane me "ftesa" për intervista në mediat e vendit fqinj. I spostuar në një cep të "Porta a Porta" në kanalën kryesor publik italian mbas mesnate, me panelistë të zgjedhur me kujdes, për të dhënë mesazhet e duhura në mbështetje të kryeministrit, do duket deri diku interesant, nëse stili i tij i njohur i vitit zero, që kur mori detyrën, të mos shkelqente që në nisje, me një insert televiziv, ku Shqipëria e para Edi Ramës, identifikohet me atë të eksodit të marsit 1991. Këtyj krahasimi që vetëm një mendje si e Edi Ramës mund të guxojë ta bëjë, i mëshoi sipas skenarit, edhe miku i tij i vjetër Iglj Tare, duke kapërcyer pacipësisht arritje kokëforta të Shqipërisë, jo nën qeverisjet socialiste, si anëtarësimi në NATO apo liberalizimi i vizave.

Qesharake deri në dhimbje akrobacitë e një kryeministri, që në gjashtë vite nuk ka asgjë për të shënuar në avancimin e vendit drejt BE, e sot akuzon opozitën, se po pengon integrimin, pasi bëri sakrificën radikale për një forcë politike, dorëzimin e mandateve, për t'u bashkuar me qytetarët kundër këtij kryeministri, që propagandën e kushtueshme e ka investimin primar të qeverisjes së tij. Kryeministri i një vendi që pret hapjen e negociatave, pasi i hapi njëherë një vit më parë, ka detyruar opozitën të braktisë parlamentin, pasi njihje si formë dialogu vetëm forcën e kartonëve dhe kapjen e çdo institucioni të pavarur. Edi Rama e kupton se afera e vjedhjes së zgjedhjeve e korrupsionin galopant, që mban peng në sir-



tarët e prokurorisë, i kanë edhe partnerët e fuqishëm ndërkombëtarë, të cilët prej kohësh tashmë refuzojnë t'i japin mundësi kontakti direkt. E para Kancelarja Merkel, e pas saj edhe udhëheqës të tjerë, të cilët në fillim nën shembullin e Merkel, e pritën dhe e inkurajuan Edi Ramën si kryeministër, por më pas, u stepën, kur kuptuan se raportet që u vinin nga Komisioni Europian, nuk përkonin me informacionet, që secili vend i siguron nga burime të veta, zyrtare apo të hapura. Edi Rama ia doli t'i fshinte nga raportit i progresit, edhe ish-ministrin e Brendshëm nën akuzë për trafik ndërkombëtar droge, edhe personat me rekorde kriminale në pushtetin qendror e vendor, edhe blerjen e zgjedhjeve, edhe korrupsionin galopant me PPP, edhe varfërinë e mungesën e shpresës që i sjell një eksod në heshtur të qytetarëve të vet.

Qesharake deri në dhimbje akrobacitë e një kryeministri, që në gjashtë vite nuk ka asgjë për të shënuar në avancimin e vendit drejt BE, e sot akuzon opozitën, se po pengon integrimin, pasi bëri sakrificën radikale për një forcë politike, dorëzimin e mandateve, për t'u bashkuar me qytetarët kundër këtij kryeministri, që propagandën e kushtueshme e ka investimin primar të qeverisjes së tij.

Atë ndikim të errët të këtij kryeministri në administratën aktuale të Komisionit Europian, është diçka që Merkel me të ngjashmit e vet në Këshillin Europian, e kuptojnë qartë, dhe e shprehin përmes votës ndaj Shqipërisë. Njëllor e kuptojnë se ai lobim i kushtoi edhe Maqedonisë qershorin e kaluar, që u tërhoq pas nga Shqipëria, pasi kryeministri nuk e kishte "luksin" të spikaste si i refuzuari i vetëm për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Fatkeqësisht kostoja e lobingjeve të kushtueshme të kryeministrit i mbeti shqiptarëve, sepse përgjigja e vendimmarrësve të BE, që në vendet e tyre kanë parime krejt të kundërta pune e demokracie me kryeministrin artist shqiptar, ishte lënia jashtë dere e Shqipërisë. Por kryeministri i Shqipërisë po u rezultoi edhe më i rezikshëm se ai lloj lobimi. Tashmë e kanë parë qartë rolin e

tij në idenë e shkëmbimit të kufijve mes Kosovës e Serbisë, ku kufiri mes delirit për t'u fakturuar në sytë e kujt ka zhgënjyer, dhe përdorimit të turpshëm për interesa të errëta, është tejet i hollë.

Është normale që kancelaritë europiane të mendojnë se Edi Rama është problem i shqiptarëve, sepse ai këtu i ka marrë votat, me hir e pahir. Prandaj aksioni ynë opozitar me protestat qytetare ka marrë vëmendje të lartë, sepse nuk janë vetëm opozitarët, por edhe shumë qytetarë të revoltuar para kryeministrit e para parlamentit. Zërat e koordinuar të burrokratëve të Brukselit, të njëjtët që shkruan turpshëm vetëm arrijtje në progres raportin e fundit të Shqipërisë, nuk e zhurmojnë dot heshhtjen e vendimmarrësve të lartë politikë të Bashkimit Europian, për aksionin ku opozita ka fuar qytetarët. Mediat e vendeve të tyre, ndryshe nga kryeministri, flasin për një qeveri të korruptuar e një kryeministër që pasi ka blerë votat, ka kapur çdo pushtet e sidomos gjyqësorin, që nuk e lejon të ndëshkojë asnjë prej të vetëve, edhe pse ka fakte flagrante.

E Edi Ramës tashmë i ka mbetur veçse të bëjë lolon në Itali, i ndihmuar nga miq po aq kontroversë sa ai, duke lypur vëmendje si artist i pazbuluar, pasi tashmë besueshmërinë si kryeministër, jo vetëm nga shqiptarët, por edhe nga ndërkombëtarët, e ka në shifërën e vet të preferuar, ZERO.

HOROSKOPI

DASHI

Në momente të caktuara sot, mund të ndiheni sikur po përpigjeni ta mbani kokën mbi ujë, por mos e humbni shpresën. Deri në fund të ditës, do të merrni të gjithë mbështetjen dhe ndihmën që ju nevojitet.

DEMI

Jini të guximshëm sot dhe flisni për një ngjarje të sikletshme të së shkuarës tuaj me një mik. Edhe pse ky sekret do t'ju bëjë të ndiheni si e zhveshur, me vonë do të ndjeni lehtësim.

BINJAKET

Një ide që keni konsideruar si një nocion radikal do të duket shumë më i arsyeshëm sot, megjithëse mund të ndryshojë jetën tuaj. Hapni mendjen tuaj dhe ndehuni i lirë të dilni jashtë rutinës tuaj normale.

GAFORJA

Sot ju do t'ju kërkohet të zgjidhni midis të ushqyerit të stomakut dhe të ushqyerit të zemrës tuaj. Përpiguni të shkoni për opionin që ushqen mendjen tuaj. Në planin afat gjatë, ju do të fitoni më shumë nga një përvojë personale.

LUANI

Kur dy personalitete të mëdha takohen sot, mund të shpërthejnë fshëkzjarre mahnitëse. Të lindurit në shenjë e luant kanë karakter të jashtëzakonshëm, por nuk e shpërfaqin atë në çdo moment.

VIRGJERESHA

Ka ardhur momenti për të ndryshuar rutinën tuaj. Nëse mendoni se mënyra juaj e të bërit të gjërave nuk është aspak interesante apo efektive, duhet ta konsideroni këtë një kohë eksperimentale në jetën tuaj duke eksploruar mënyra të reja të të menduarit dhe veprimit.

PESHORJA

Njëzërit që ju thonë se konfliktet kurë nuk sjellin kënaqësi janë njëzërit që nuk e kuptojnë artin e negociatave dhe debatit. Nuk ka nevojë të frikësoheni kur njëzërit nuk bien dakord me ju. Shikoni mosmarrëveshjet si mundësi edukimi.

AKREPI

Disa mosmarrëveshje duhen sqaruar sa jeni në kohë. Ekziston një probabilitet i lartë që një keqkuptim të bëhet shkak i një stresi. Sa i përket financave, gjasat janë që të merrni lajme të mira.

SHIGJETARI

Thuhet se të huajt janë miq të cilët nuk i keni takuar ende. Një person që mund të takoni sot mund të bëhet një shok shumë i mirë, dhe varet sesi do ta ruani dhe forconi këtë lidhje të re.

BRICJAPI

Do të jeni i rrethuar nga një energji pozitive që do t'ju bëjë të ndiheni shumë mirë. Kjo është një kohë e mrekullueshme për të provuar një skemë të re sa i përket financave tuaja.

UJORI

Kur dikush pyet se kush është frymëzimi juaj, a dini të përgjigjeni? Gjithkush ka nevojë për një muze, dhe të gjithë kanë nevojë për një hero apo heroinë personale. Nëse nuk keni një idhull, gjiejni një.

PESHQIT

Ju mund të ndeheni sikur po jetoni sot një nga ëndrrat tuaja më të këndshme, kur rasti të çuditshme dhe këthes qesharake të fatisi ju përshëndesin në çdo hap. Sa më shumë lëvizni sot, aq më shumë emocio do të përjetoni!

PRESIDENTI I KAMZËS

Qarri: I kërkova ndjesë Hamitit, mendoni për lojtarët

Presidenti i Kamzës, Naim Qarri, ka kërkuar ndjesë për dhunën që ka ushtruar ndaj gjyqtarit Eldorian Hamiti në përfundimin e ndeshjes Kamza-Laçi. Ai ka kërkuar ndjesë në një prononcim për "Top Channel", ku rrëfen se ka telefonuar Hamitit dhe i kërkon federatës të rish-

ikojë dënimin për Kamzën në emër të familjeve të lojtarëve. "Ndihehem shumë keq për ngjarjen që ndodhi. Unë nuk jam për dhunë. I kërkova falje të gjithë familjarëve dhe ata që ishin aty. Telefonatën e parë ia kam bërë Hamitit dhe i kam kërkuar falje. Do t'i u lutesha

të gjithë mediave, ta heqin atë pjesë e dhunës, sepse është bërë si film. Shpresoj që të merren një vendim më i lehtë. Të paktën të mendojnë për ata futbollistët, se kanë familje. Unë i bëj thirrje Federatës që ta shikojnë edhe njëherë atë vendim", u shpreh Qarri.

"PIBE DE ORO"

Maradona: Përse FIFA lejon të luhet për Kombëtare të tjera?

Maradona kundër të gjithëve, sidomos kundër Infantinos. Por e ka dhe më bashkëkombasit e tij që veshin fanella të vendeve të tjera. "Pibe de Oro" nuk humbet rastin për të lëshuar silurë nga të gjitha anët. Pas barazimit me Leonos Negros, Diegito ka lëshuar artillerinë e rëndë kundrejt argentinaseve të natyralizuar, sidomos për ata që kanë pranuar të luajnë për Meksikën, vend në të ci-

lin ai sot punon. "Jam argentinase dhe nuk do të kisha luajtur kurrë për asnjë vend tjetër. Nëse këtyre djemve u ofrohet një mundësi për të fituar Botërorin dhe kjo cilësohet e kënaqshme, unë mendoj se të përfaqësosh një kohë dhe të luash për zemrën, është një hendek i madh shumë". Po In-

fantino ç'hyn këtu? Hyn që çke me të sepse Maradona për këtë problem ka folur dhe me të. "Më pati thënë se gjërat do të ndryshonin, por në fakt kanë mbetur njësoj. Infantino nuk di t'i vendosë gjërat në vend, duhet të konsultohet me ne lojtarët që kemi luajtur në Botërorë".

Kreu i Kukësit dhe ai i Skënderbeut mbështesin arbitrat në vendimin e tyre për të bojkotuar

Takaj e Gjici në unison: Dhuna ishte e orkestruar!

Flasin dy nga presidentët kryesorë të superiores



Jeton Selimi

Situata që po kalon këto ditë futbollit shqiptar, ku bojkoti i arbitrave ka sjellë pezullimin e të gjithë aktiviteteve futbollistike në vend, mund të ishte parandaluar kohë më parë. Mos prezenca e policisë së shtetit në stadione e bënte shumë të prekshtëm këtë produkt, futbollin, kjo u pa qartë që në javën e parë në sfidën Skënderbeu-Partizani, ku tifozët u futën në fushë duke u përplasar ndërmjet tyre.

Takaj. Nga aktorët e parë që reagon dhe kërkuar rikthimin e policisë në stadione, për të shmangur pikërisht këtë që ndodhi në Kamzës, ka qenë dhe Ardian Takaj. Në një intervistë ekskluzive për Balkanweb, presidenti i Skënderbeut thekson se gjithçka është e qëllimshme, pikërisht për të bërë pis një nga të paktët produktë që po funksiononte në Shqipëri: "Dhuna? Më duket e qëllimshme që dhe sporti të përshatet më situatën që po ndodh në vend. Nuk është aspak rastësi ajo që ndodhi, ishte diç-



ka që e kemi paralajmëruar që në fillim. Ata që hartuan këtë ligj, për largimin e policisë nga stadionet, e

dinin shumë mirë që do vinte ky moment. Bojkoti i arbitrave? Është vendimi më i drejtë që mund të

kenë marrë ndonjë herë. Duhet ta çojnë deri në fund me çdo kusht. Nuk është koha për të bërë shfaqje,

duhet të ruajmë këtë produkt për të cilin kemi vite që punojmë. Gjithçka e mirë që është bërë mund të zërohet brenda pak muajsh. Është një goditje e madhe për imazhin e futbollit shqiptar.

Në të njëjtën linjë është edhe presidenti i Kukësit, Safet Gjici, i kontaktuar nga Balkanweb. Gjici theksoi se është e pamundur të vijohet gara në këto kushte: "Vendimi i arbitrave ishte i drejtë. Në këto kushte është e pamundur të vijohet gara, pasi situata mund të precipitonte akoma më shumë. Prezenca e Policisë në stadione është e domosdoshme për sigurinë e garës, u shpreh Gjici, i cili shtoi se për ekipin e tij ky vendim nuk ka asnjë efekt.

PUBLIKOHET LISTA

Mesi rikthehet tek Argjentina, Ikardi mbetet jashtë

Pasi i dha lamtumirë Kombëtares së Argjentinës pas zhgënjimit të madh në Botërorin e Rusisë, "Pleshti" ka vendosur t'i thotë "po" trajnerit të ri, Lionel Skalonit, ndaj emri i tij është pjesë e të grumbulluarve për miqësoren kundër Venezuelës më 23 mars. Mediat argjentinase nuk janë në gjendje të saktësojnë nëse ai do të luajë kundër Venezuelës në Madrid, apo nëse do të jetë i disponueshëm dhe për miqësoren në Tanageri kundër Marokut. Gjithsesi fakt është që Mauro Ikardi mbetet jashtë Kombëtares, por është grumbulluar shoku i tij tek Interi, Lautaro Martinez, ndërsa do të jetë dhe Paolo Dibala.

Dridhet Manchester Siti, UEFA nis hetimin ndaj klubit anglez

Organi i pavarur i kontrollit financiar për klubet i UEFA-s, Investigatory Chamber, ka nisur një hetim formal ndaj Manchester Siti në lidhje me shkëlqetë mundshme të rregullores së Fair-Play Financiar. Lajmin e komunikoi vetë qeveria e futbollit evropian në sajtin e saj zyrtar, duke shpjeguar se hetimi do të përqendrohet në disa pikë, të cilat mendohet të jenë shkelur nga ana e klubit anglez për të anashkalluar rregullat e FFP. Mediat britanike e kishin lëshuar alarmin e një dënimi të mundshëm që në fund të vitit të shkuar, teksa publikuan informacione të ndryshme në lidhje me një dënim të mundshëm dhe të rëndë të Manchester Siti nga ana e UEFA-s.

MBROJTËSI I BAJERNIT

Lëv e hoqi nga Kombëtarja, reagon Humels: S'është e drejtë!

Joakim Lëv hoqi nga skuadra përfaqësuese e Gjermanisë tre lojtarë të Bajernit të Mynihut, duke u thënë se nuk do të grumbullohen më me "pancerat", pasi ekipi kombëtar do të nisë fazën e rinovimit. Mats Humels, Zherom Boateng dhe Tomas Myler ishin lojtarët që Lëv vendosi t'i largojë nga përfaqësuesja, ndërsa Humels ka reaguar: "Unë dua të komentoj vendimin e trajnerit të kombëtares. Mendoj që ka qenë një vendim shumë i vështirë (të cilin e respektoj, natyrisht), por mënyra se si e kam marrë është e pakuptueshme. Sipas mendimit tim, gjithmonë kam pasur



një marrëdhënie të mirë me njerëzit e përfshirë në skuadrën tonë dhe në gjithmonë e kemi trajtuar njëri-tjetrin në mënyrë të drejtë. Tomas, Zherome dhe unë kemi dhënë gjithçka për

ekipin kombëtar për vite me radhë dhe për mendimin tim ky vendim nuk është i drejtë ndaj asaj që kemi arritur. Mund të them se ata ishin vite të mrekullueshme, 70 ndeshje ndërkombëtare që tejkalojnë gjithçka që kisha ëndërruar si fëmijë. Një total prej katër turneve të mëdha ku mu lejua të merrja pjesë, 70 kurorëzua edhe fitimin Kupën e Botës 2014. Unë do ta mbaj atë ndjenjë përgjithmonë dhe unë me të vërtetë do të doja të bëja gjithçka për të përsëritur diçka të ngjashme" shkruan Humels në profilin e tij.


TAKIMI NË KRYEMINISTRI

Rama takon Dukën, pritet zgjidhje për futbollin

Futbolli i bllokuar nuk i interesin askujt, ndaj është normale që të kërkohet një zgjidhje sa më e shpejtë. Pas bojkotit të arbitrave, që nuk do të rikthehen të gjykojnë nëse policia nuk do të jetë prezente në stadione për të garantuar jetën e tyre, edhe Federata Shqiptare e Futbollit mbështeti vendimin e Shoqatës së Arbitrave. Në këto kushte, në kryeministri është zhvilluar një takim mes Edi Ramës dhe Armando Dukës. Se çfarë kanë biseduar me njëri-tjetrin kreu i qeverisë me kreun e FSHF-së, ende nuk dihet, por sinjalet janë pozitive dhe mund të kemi një zgjidhje të situatës.



Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL**
1. Niven që qe aktor.
 7. Little... kryeqyteti i Arkansas.
 7. Janë tek në lakër.
 10. Nuk ka akoma një bebe.
 11. Kufizojnë katete.
 12. Penn aktor.
 13. Hector që shkroi Pa familje.
 15. Thahen me bonifikime.
 18. Mbyllin takimin.
 19. Ndërmarrje Industriale Mat.
 21. Mbyllën me epilog.
 23. Tregohen indiferentë dhe aspak të gjallë.
 25. Ishin sandalet e lëkurëkuqve.
 27. Njëlloj për latinet.
 30. Eshhtë vend si Katari.
 31. Pupi regjisor.
 32. Janë strehat e çobanëve.
 33. Eshhtë centrali si Chernobyl.
 35. Fillojnë një argument.
 36. Të parat në stadium

37. Mund të sjellin shi.
38. Kështu fillon Odisea.
39. Një mund të jetë emërore.
42. Thirrej edhe kështu Persefoni.
44. Ai dhe ajo.
45. E ka lënë atë që s'ka fuqi
48. Para es Salaam.
49. Ylli i Londrës.
50. Eshhtë syzë... në komo.

- VERTIKALI**
1. Hyskja aktor.
 3. Kush e thotë lutet.
 3. Një tis mjegulle.
 4. Maiden që këndojnë.
 5. Gjysmë rekord.
 6. Antonio skulptor i famshëm.
 7. David regjisor.
 8. Janë brinjë në skuadër.


9. Ruan në kufij.
12. Mban mikrofonin.
14. Janë edhe ato të fytyrës.
16. Qureshin edhe Eumenide.
17. Demek pa kufij.
20. Mund të jetë atomike.
22. Qyteti i përjetshëm.
24. Kitara e Ravi Shankar.
25. Janë katrore në sipërfaqe.
26. Një fjalë si goja.
28. Pak daktilografi.
29. Eshhtë si divan.
31. Një pjesë e amerikanëve.
32. Bernhardt që qe aktore.
34. Eshhtë infeksion në veshë.
38. Një mund të jetë unik
40. Gjysma e sasisë.
41. Pak marramendëse.
43. Eshhtë dhomë.
45. Fillojnë takimin.
46. Në fund majtas.
47. Të fundit në manastir.

Fjalëkryqi (2)

- HORIZONTAL**
1. E bardhë ajo Moby Dick.
 5. Fillojnë amplifikimin.
 7. Eshhtë vit që parashikohet.
 10. Mbyllin pamjen.
 11. U printe jeniçerëve.
 13. Thurman aktore.
 14. Një reaksion në provëz.
 16. Një sport me brez të zi.
 19. Në fund të fundit.
 20. Janë në gjyq.
 23. I është hequr të dënuarit.
 24. Eshhtë shahu i fundit
 25. Janë fletë trëndafil.
 27. Kufizojnë një metër.
 28. Tregojnë pallate në miniaturë.
 29. Një fjalë pa shkak.
 30. Janë përlogaritje.
 32. Mbyllin një dritare.
 33. Të parat në muzg.
 34. Me të nxjerrin një letër.


35. Janë me ngjyra të tilla si tunxhi.
37. Toromani balemirë.
39. Iniciale e Reimman regjisor.
40. Fillojnë politikën.
42. Një piktor si Antonio Ligabue.
44. Diftong në dietë.
46. Një lind në kokë.
48. Kush ka... do të pijë.
49. Punojnë në galeri.
52. Fillojnë titrat.
53. Mund të jetë ekspres.
54. Mund të skadojë.

- VERTIKALI**
1. Ishte titulli i Hiro Hitos.
 2. Ekberg aktore.
 3. Eshhtë skuadra.
 4. Dy asa.
 5. Binjakët në klasa.
 6. Qe duhet sajdisur.




7. Nuk i bihet me kokë.
8. Sharif aktor.
9. Janë organet e taksave.
12. Me Haensel në përrallat e vëllezërve Grimm.
15. Vihen për të mbyllur.
17. Janë vegla.
18. Eshhtë medalja e të parit.
21. I dhimbset frikacakut.
22. Mund të jetë mbi xhiro.
26. Eshhtë llathar.
28. Janë inate të akumuluarra
30. Eshhtë vëlla i gruas.
31. Një tip për të këcyer.
33. Edoard piktor.
36. Lumë në Francë.
38. Janë djemtë e... nënës.
41. Lindi Akilin.
43. Kodi i celularit.
45. Mbledh basket separatistë
47. Një është edhe Egjieu.
49. Fillojnë një metodë.
50. Dy anët e një neni.
51. Fillojnë ofensivën.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

SEVENUP STEFFELI
AMIN KAPITALI
RITETET REL AM
ALETET FLOKTEETI
HE KAMIKAZE K
PROTOKOLLARE
KATAMARAN I OT
IR COLIN ROMY
TEMATE I BORTS
ANITAA MILANO
RAN VIT MJEKIAN
ETILEN FRATTI

FJALËKRYQI (2)

BAOBAB PEDANAT
R PERIPATETIKER
APEL RITVBNAR
VELPIRAMIDA M
AR KOLORITILE
PROTAGONISTET
KANATA KATTE
TRIELTAKUKTI
SANTALIKTESI
PAE SIPIRATIT
IRMI BANORET
KRATERET GJIRI

SUDOKU

		2						3
	9						1	
			8					
			5	1				
4	6			7				
		7				6	1	
6							8	5
7			2	3	8			
			4				9	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	1	3	7	4	5	2	6	8
8	4	2	9	6	3	5	1	7
5	6	7	8	1	2	9	3	4
4	2	9	1	7	6	3	8	5
1	5	8	2	3	4	6	7	9
7	3	6	5	8	9	1	4	2
2	8	4	3	5	1	7	9	6
6	9	1	4	2	7	8	5	3
3	7	5	6	9	8	4	2	1

Argëtim filozofik

- I vetmi person që mund të kontrollosh në një marrëdhënie, është vetvetja.
- Gjëja më e mirë që ka për të bërë dikush që nuk është i sigurt në vetveten e tij, është të hesht.
- Për të kërkuar arsyen se pse një dashuri mbaroi, është sikur të kërkohe arsyen se pse ajo filloi!!!
- Nëna është si qiri, që djeg veten për të ndriçuar jetën tonë!!!
- Për gjërat që nuk mund të flasësh, duhet të heshtësh.
- Heshja është flori, kur nuk mund të mendosh një përgjigje të mirë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

2 11 2 11 1 7 1 13 4 1 3
4 6 2 15 1 3 6 4 1 3 6
5 2 7 8 7 2 11 1 8 1 3
17 1 13 6 12 9 5 1 3 5
17 1 7 9 13 9 12 6 2 4
5 2 8 9 7 1 12 1 3 11 1
2 13 3 1 13 2 2 3 2 2 15
13 2 13 3 1 16 3 8 2 5 2
7 13 1 6 6 8 6 5 1 3
6 15 2 13 2 7 2 1 7
15 B A F R T 2 9 1 3 13 1 4
1 15 2 16 3 6 2 17 2 3 6

A Z O V E T N A B A
Z A G A R R A M B A S
I C K A L I N I O B I
L C A S U S B E L L I
T E N T A T I V A T V
M A R T I N A E N K E
E T E S E N R O M A N
T I M E T I P I A F E
A M O R F R A T A R
L O N Z E T A F A Z A
E R I C C E V O N E
T E A M A L B A N E T

Thënie të mençura

- Problemi më i madh i komunikimit, është se, nuk dëgjojmë për të kuptuar, por për t'u përgjigjur.
- Ato që nuk duhet të bëjmë, nuk duhet as t'i mendojmë.
- Ndonjëherë thjesht duhet të shikoni prapa në të
- kaluarën dhe të buzëqeshni për sesa larg keni shkuar.
- Vetëm kur të fillojmë të jemi zgjuar, kuptojmë sesa të fjetur ishim.
- Në përpjekje për të bërë të tjerët të lumtur, kam harruar veten time!!!

